



Raporti vjetor 2014

1. Të dhënat kryesore financiare	4
2. Raporti nga Kryetari i Bordit Udheheqës të Bankës	5
3. Bordi Udheheqës i NLB Prishtina	6
4. Ambienti Makroekonomik dhe zhvillimi i tregut	7
5. Strategjia	8
5.1 Misioni, Vlerat dhe Vizioni	8
5.2 Objektivat Strategjike	8
6. Performanca dhe rezultatet financiare	10
6.1 Komentimi i pasqyrës së pozicionit financiar	10
6.2 Komentimi i bilancit të suksesit	13
7. Aktivitetet sipas segmenteve afariste	15
7.1 Afarizmi me personat juridik	15
7.2 Afarizmi me retail	16
7.3 Thesari dhe pagesat	17
7.4 Teknologjia informative	18
8. Menaxhimi i Riskut	20
9. Përgjegjësia sociale e korporatës	21
9.1 Aktivitetet sociale dhe ambientit	21
10. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	22
11. Qeverisja Korporative	23
11.1 Qeverisja Korporative dhe Organet Menaxhuese	23
11.2 Auditimi i brendshëm	26
12. Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit	27
13. Adresat dhe kontaktet	108

1. Të dhënat kryesore financiare

000 EUR	2013	2014	Index 2014 / 2013
Koeficientët			
ROE pas tatimit	7.4%	11.2%	151.4%
ROA pas tatimit	0.7%	1.2%	171.4%
Raporti të hyra/shpenzime (CIR)	56.3%	48.9%	86.8%
Rangimi me Gjithsejt Asetet	3	3	100.0%
Indikatori i mjaftushmerisë së kapitalit (BQK)	16.5%	16.6%	100.5%
Kapitali Tier 1 sipas BQK	40,670	50,222	123.5%
Treguesit e bilancit të gjendjes			
Shuma e bilancit	464,095	463,501	99.9%
Kreditë e SJB (neto)	240,368	252,365	105.0%
Depozitat (SJB)	407,863	404,650	99.2%
Gjithsej ekuiteti	45,913	51,454	112.1%
Margjina e interesit	3.7%	4.2%	112.7%
Treguesit e bilancit të suksesit			
Neto fitimi	3,286	5,435	165.4%
Rezultati financiar para tatimit	3,699	6,132	165.8%
Gjithsej të hyrat	17,797	21,244	119.4%
Neto të hyrat kamatore	14,021	17,816	127.1%
Neto të hyrat komisionet dhe tarifet	3,470	3,401	98.0%
Shpenzimet operative gjithsej	(10,016)	(10,379)	103.6%
<i>Shpenzimet e pagave</i>	<i>(5,086)</i>	<i>(5,150)</i>	101.3%
<i>Shpenzimet tjera operative</i>	<i>(3,859)</i>	<i>(3,955)</i>	102.5%
<i>Amortizimi</i>	<i>(1,071)</i>	<i>(1,274)</i>	118.8%
Kualiteti i portofolit dhe provizionet			
Bruto kreditë e NBS	265,526	281,451	106.0%
Portofoli kreditor	365,777	399,583	109.2%
Provizionet e kredive dhe rezervat (SJB)	(25,158)	(29,086)	115.6%
Rritja e provizioneve dhe rezervave të tjera (bilanci i suksesit)	(4,082)	(4,733)	115.9%
Mbulesa e bruto kredive të SJB me provizione	9.5%	10.3%	108.8%
Mbulesa e portfolios kreditorë me provizione	7.5%	8.0%	106.7%
Raporti i KJP në gjithsej kreditë	6.2%	6.0%	96.4%
Raporti i KJP të Sektorit jobankar	7.4%	7.7%	104.4%
Mbulesa e KJP me provizione (Raporti i mbulesës)	126.5%	132.7%	104.9%
Treguesit e likuiditetit strukturor			
Pjesëmarrja e burimeve të SJB në shumën e bilancit	87.9%	87.3%	99.3%
Koeficienti i Bruto kredive SJB/depozitave SJB (LTD)	65.1%	69.6%	106.8%
Koeficienti i neto kredive SJB /depozitave SJB (LTD)	58.9%	62.4%	105.8%
Burimet (resurset)			
Numri i të punësuarve	525	525	100.0%
Numri i filialeve	9	9	100.0%

2. Raporti nga Kryetari i Bordit Udhëheqës të Bankës

Të nderuar miq të NLB Prishtina!

Banka NLB Prishtina, model i një banke të qëndrueshme dhe të suksesshme në Kosovë

Banka NLB Prishtina është pjesë e Grupit NLB, institucionit më të fuqishëm bankar në Slloveni dhe një ndër më të rëndësishmit në regjion. Fitimet e vitit 2014 filluan të ndikojnë pozitivisht në performancën e NLB Grupit duke eliminuar vështirësitë e viteve të kaluara. Strategjia e implementuar në kuadër të grupës nxiti rritje të kujdeshme dhe qëndrueshmëri afatgjatë. Viti 2014 shënon një vit të kthesës pozitive dhe konsolidim të plotë të afarizmit financiar dhe bankar.

NLB Grup ka pasur një vit të suksesshëm në vitin 2014 me një fitim neto prej 62.3 milion EUR që është një lajm shumë pozitiv dhe inkurajues jo vetëm për Bankën NLB në Slloveni, por edhe për Grupin NLB në përgjithësi dhe për bankën NLB Prishtina në veçanti.

Grupi NLB ka një prezencë të fuqishme në tregjet e vendeve të Europës Juglindore si në: Kosovë, Maqedoni, Serbi, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë. Duke e vlerësuar rëndësinë strategjike të kësaj prezence në regjion, Grupi NLB edhe gjatë vitit 2015 do të vazhdojë me procesin e transformimit, konsolidimit dhe rritjes së mëtejme në të gjitha segmentet e afarizmit.

Sot, NLB d.d. është Banka më stabile dhe më e madhe në Slloveni, e kapitalizuar shumë mirë dhe me likuiditet të mjaftueshëm. Rezultatet e mira dhe fitimi i realizuar gjatë vitit 2014, paraqesin një garancë për zhvillim të mëtejme dhe një tregues të rritjes së kapitalit i cili plotësisht i përmbushë limitet për kapital sipas kërkesave të Bankës Qendrore Evropiane.

NLB Prishtina është bankë me kapital slloven, e themeluar në vitin 2008 dhe përfaqëson një model të një banke të qëndrueshme dhe të suksesshme në Kosovë. Viti 2014 është viti i shtatë me radhë i vazhdimësisë së numërimit të sukseseve të bankës.

Banka NLB Prishtina, ka vazhduar me sukses të plotë zhvillimin e saj në të gjitha segmentet e afarizmit. Të gjitha objektivat afariste të parashtruara janë realizuar ose tejkaluar dhe janë arritur përmirësimet në shumicën e treguesve kyç të performancës.

Në përputhje me rrethanat dhe mundësitë, pjesëmarrja e Bankës NLB Prishtina në treg ka shënuar rritje dhe **ka arritur që të konsolidojë pozitën e saj në mesin e tre bankave më të mëdha dhe më të rëndësishme në tregun bankar të Kosovës**, si për nga shuma e totalit të mjeteve, po ashtu dhe për nga depozitat e klientëve. Këta tregues reflektojnë më së miri interesin dhe besimin që kanë klientët ndaj bankës.

Si rezultat i strategjisë për një rritje të kujdeshme, NLB Prishtina për vitin 2014 ka realizuar një fitim pas tatimit në shumë prej 5.4 milion EUR, ose 65% më i lartë krahasuar me vitin paraprak. Neto kreditë e sektorit jo-bankar në fund të vitit 2014 kanë qenë 252 milionë EUR ose ka rritje 5% krahasuar me fundin e vitit paraprak. Mbulesa e bruto kredive të sektorit jo bankar me provizione është 10.3%, ndërkaq kreditë jo performuese janë të provizionuara me



Albert Lumezi

Kryetar i Bordit udhëheqës të Bankës

132.7%. Indikatorit e efijencës (CIR), në raport me planin vjetor prej 56.4% është përmirësuar në 48.9%, si rezultat i menaxhimit efektiv të shpenzimeve operative dhe i rritjes së të hyrave operative. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit për vitin 2014, është 16.6% duke reflektuar kështu mbulesë të qëndrueshme të adekuatshmërisë së kapitalit dhe menaxhim efikas të kapitalit.

NLB Prishtina është e përkushtuar ndaj klientëve të saj, në kuptimin sa më të mirë të kërkesave të tyre dhe ofrimit të mbështetjes adekuate në përmbushjen e objektivave të tyre. Kjo mundësohet me ofrimin e produkteve dhe shërbimeve efikase, kualitative, moderne, në ambiente komode, diskrete dhe të sigurta, me një staf te trajnuar dhe me integritet të lartë etik dhe profesional.

NLB Prishtina duke qenë ekonomikisht e suksesshme dhe konkurruese, krijon vlerë të shtuar për të gjithë akterët e saj, përfshirë aksionarët, klientët, të punësuarit si dhe për tërë shoqërinë. Vlen të përmendet kontributi i bankës në fushën e përgjegjësisë sociale, duke mbështetur në mënyrë të vazhdueshme projekte dhe programe sociale duke sponsoruar aktivitete të rëndësishme të jetës ekonomiko shoqërore, artistike, sportive, shëndetësore dhe humanitare në vend.

Banka NLB Prishtina ka vizion dhe objektiva të qarta zhvillimore dhe ambicioze, për vitin 2015 por edhe për vitet në vazhdim. Synimi i kryesor i bankës është për një vazhdim të sukseseve të saj, me rritje konstante dhe të qëndrueshme në të gjitha segmentet e biznesit, gjithmonë dukë pasë parasysh motivin themelor - **sigurinë e kapitalit të bankës dhe të klientëve** të saj. Synojmë të jemi inovatorë, duke sjellë zgjidhje dhe ide të reja të cilat kanë si qëllim rritjen e mëtejshme të efijencës. Synojmë poashtu të jemi social, duke qenë akter aktiv dhe kontribues në shoqërinë kosovare.

Banka NLB Prishtina është mirënjohëse të gjithë klientëve të saj dhe partnerëve afaristë për besimin që ata kanë te banka si partner i tyre afatgjatë. Posaçërisht vlerësojmë punonjësit e bankës NLB Prishtina për kontributin dhe përkushtimin e tyre në arritjen e këtyre rezultateve të mira, që premtojnë një të ardhme më të mirë, për të gjithë.

Albert Lumezi,

Kryetar i Bordit udhëheqës të Bankës

3. Bordi Udhëheqës i NLB Prishtina



Lavdim Koshutova
Anëtar i Bordit Udhëheqës të Bankës

Albert Lumezi
Kryetar i Bordit Udhëheqës të Bankës

Bogdan Podlesnik
Anëtar i Bordit Udhëheqës të Bankës



Menaxhmenti i bankës


4. Ambienti Makroekonomik dhe zhvillimi i tregut

Në vitin 2014, rritja ekonomike në Kosovë ka qenë modeste dhe në disa mënyra më e qëndrueshme sesa në vendet fqinje. Norma e rritjes ekonomike për vitin 2014 ishte 3.0 %, krahasuar me 3.8 % sa ishte në vitin e kaluar. Kjo rritje ka qenë kryesisht si rezultat i rritjes së konsumit, ndërkohë që investimet dhe eksportet neto kanë pasur një kontribut negativ.

Në vitin 2014, ekonomia është karakterizuar me një rritje të kredidhënies bankare, shpenzimeve rrjedhëse/korrente të qeverisë dhe rritje të remitancave. Megjithatë, rritja e deficitit tregtar dhe rënia e investimeve publike dhe në investimet e huaja direkte në vitin 2014 ka rezultuar në një normë vjetore më të ngadalshme të rritjes.

Ekonomia vazhdon të karakterizohet nga një deficit i lartë tregtar dhe shkallë të lartë të papunësisë që paraqet sfidën kryesore për stabilitetin ekonomik dhe social në vend.

Ilustrimi 1: Rritja reale e GDP dhe Inflacioni -CPI (mesatarja për periudhën



Burimi: IMF dhe CBK publikimet

Inflacioni - (IÇK) - ka vazhduar të shënojë rënie, dhe për vitin 2014 është zvogëluar në 0.4%, krahasuar me 1.8% që ishte në vitin e kaluar. Niveli i inflacionit në Kosovë në masë të madhe pasqyron ndryshimet në çmimet e importit, të cilat reflektohen kryesisht në ekonomi përmes çmimeve të ushqimit dhe çmimeve të naftës.

Investimet e huaja direkte dhe Remitancat - Remitancat vazhdojnë të paraqesin një burim të qëndrueshëm të të ardhurave dhe një element kryesor të kërkesës së brendshme dhe të rritjes, dhe ato kanë shënuar rritje në vitin 2014, ndërsa investimet e huaja direkte kanë shënuar një nivel dukshëm më të ulët në krahasim me vitin paraprak.

Niveli i lartë i papunësisë, që është një nga problemet më të mëdha të Kosovës ende mbetet shumë i lartë, dhe është më i madhi në rajon.

Sistemi bankar në Kosovë ka vazhduar që të rritet në vitin 2014, por me një rritje më të ulët krahasuar me vitin e kaluar. Më 2014 në Kosovë kanë operuar dhjetë (10) banka.

Sistemi bankar vazhdon të mbetet i kapitalizuar mirë, likuid dhe fitimprurës. Kreditë joperformuese të sektorit bankar janë të qëndrueshme në pak mbi 8 për qind dhe janë të provizionuara mirë.

NLB Prishtina në vitin 2014 vazhdoi të jetë banka e tretë më e madhe në tregun e Kosovës me asetet e saj të përgjithshme dhe depozitat. Dhe vazhdon të ketë pjesëmarrje të tregut bankar mbi 15% në gjithsej Asetet, Depozitat dhe Kreditë.

5. Strategjia

5.1. Misioni, Vlerat dhe Vizioni

Banka është e përkushtuar për zhvillimin e një kulture duke u fokusuar në klientin, ndërgjegjësimin e riskut, integritetin, proceset efikase dhe përgjegjësinë sociale.

Një qasje e tillë fleksibile mbështet ofrimin e shërbimeve të duhura dhe zgjidhjeve afariste për klientët. NLB Prishtina është bankë e fokusuar në klientët, duke synuar që përmes proceseve të efektshme të ofrojë vlera për klientët dhe aksionarët e saj, me qëllim që të jetë një partner i besueshëm dhe afatgjatë.

Me një përgjegjësi të madhe, dhe përmes kontributit të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, NLB Prishtina punon për ndërtimin e një partneriteti afatgjatë me klientët, aksionerët dhe komunitetin në të cilin vepron. NLB Prishtina nderon besimin e klientëve duke punuar së bashku me qëllim të përfitimit të ndërsjellë, rritjes ekonomike, si dhe duke kontribuar në ndryshimet pozitive në mjedis.

Në NLB Prishtina ne materializojmë vlerat e mëposhtme themelore brenda kulturës sonë të përbashkët:

- Përgjegjësia dhe llogaridhënia ndaj klientëve, aksionerëve, të punësuarve dhe ambientit shoqëror.
- Përkushtimi për të përmbushur premtimet dhe objektivat tona me standardet më të larta të integritetit.
- Komunikimi bashkëpunimi i hapur,
- Efikasiteti në përmbushjen e përkushtimeve tona dhe
- Një akter fitues (win-win) në menaxhimin efektiv të riskut dhe kapitalit.

NLB Prishtina do të jetë një bankë e qëndrueshme fitimprurëse, kryesisht duke punuar me klientët në segmentet kryesore të tregut ku mund të arrijë dhe të mbajë pozitën në mesin e tre konkurreseve më të mëdhenj në aspektin e profitabilitetit (relativ) dhe / ose pjesëmarrjes në treg .

Në afarizmin e saj kryesor NLB Prishtina do të dallojë në aspektin e të kuptuarit të klientit në thellësi, nivelit të shërbimeve dhe kompetencës këshilluese, sipas qasjes bankare dhe shumëllojshmërisë konkurruese produkt / kanal.

5.2. Objektivat Strategjike

Objektivat strategjike të NLB Prishtina janë bazuar në supozimin se është një Bankë ndërkombëtare me qasje lokale, që zhvillon modelin e vet afarist në përputhje me objektivat e vendosura nga kompania amë NLB d.d. dhe siguron burimet e nevojshme strategjike për rritjen dhe zhvillimin. Implementimi i tyre, megjithatë, do të përshtatet kur është e nevojshme për të reflektuar kushtet aktuale.

NLB Prishtina ka për qëllim që të jetë një nga bankat me shërbimet më cilësore dhe Banka me kredibilitet më të lartë në tregun bankar të Kosovës. NLB Prishtina e vlerëson përgjegjësinë e saj ndaj shoqërisë si punëdhënëse, Bankë dhe si një anëtare e shoqërisë Kosovare.

NLB Prishtina mbetet e përkushtuar për të kontribuar pozitivisht në ekonominë e Kosovës përmes aktiviteteve të saj afariste.

Objektivat kryesore strategjike afariste të NLB Prishtina janë:

- Të mbaj pjesëmarrjen aktuale të tregut dhe të vlerësohet nga publiku i gjerë si një nga bankat më të besueshme në treg
- Fokusimi në nevojat e klientëve dhe shoqërisë të cilës i shërben, duke ofruar vlera të qëndrueshme afat-gjate për të gjithë
- Menaxhimi efikas i riskut dhe kapitalit

-
- Të ruajë bazën e klientëve, të arrij/realizoj rritjen e vëllimit afarist si dhe rritjen e të hyrave
 - Përmirësimi i efikasitetit në të gjitha aspektet operative nëpërmjet konsolidimit të mëtejshëm të operacioneve bankare
 - Të jetë një urë lidhëse në mes të ekonomisë sllovene dhe kosovës dhe vendeve ku NLB Grup është prezent
 - Menaxhimi aktiv i portofolios kreditore dhe menaxhimi aktiv i koeficientit të LTD-së

NLB Prishtina si një bankë universale ofron shërbime të plota bankare për klientët e saj.

Shtyllat kryesore strategjike përfshijnë: Aktivitetet bankare me persona juridik, aktivitetet bankare me persona fizik si dhe Thesari dhe Pagesat.

Masat për të arritur objektivat strategjike

Banka ndjek zhvillimin në përputhje me strategjinë duke tentuar të jetë një nga bankat më të mira për klientët, duke përdorur një sërë masash të performancës. Përparimi në këto fusha është matur kundrejt një numri të treguesve kryesore financiar dhe jo-financiar të cilët janë të paraqitura në këtë raport. Objektivat specifike përcaktohen për secilën periudhë dhe periudhën 5 vjeçare. Çdo dobësi kyçe eliminohet brenda një periudhe kohore nëpërmjet monitorimit të rregullt.

6. Performanca dhe rezultatet financiare

6.1 Komentimi i pasqyrës së pozicionit financiar


Në vitin 2014, NLB Prishtina ka rezultuar me një performancë të mirë financiare duke pasur parasysh mjedisin e vazhdueshëm sfidues ekonomik dhe rregullativ. NLB Prishtina ka shënuar fitim të qëndrueshëm, kthimi të mirë, bilanc të gjendjes dhe pozicion të likuiditetit të qëndrueshëm që reflekton stabilitetin e bankës. Të gjithë indikatorët kryesor nga plani vjetor janë përbushur apo tejkaluar. NLB Prishtina vazhdon të jetë e kujdesshme dhe e përkushtuar drejt rritjes stabile, duke përdorur një qasje të kujdesshme në kreditim, që është reflektuar në një cilësi të qëndrueshme të portfolios kreditore dhe të fondeve.

Tabela 6.1.1. Bilanci i gjendjes – IFRS

000 EUR	2013	2014	Index	
			2014 / 2013	2014/2013 nominal
Pasuritë	464,095	463,501	99.9%	(594)
Paratë e gatshme në dispozicion dhe bilanci me BQK	97,163	66,282	68.2%	(30,881)
Kreditë e bankave– neto	60,034	81,844	136.3%	21,810
Kreditë e sektorit jobankar – neto	240,368	252,365	105.0%	11,997
<i>Kreditë e korporatave - neto</i>	<i>163,439</i>	<i>163,542</i>	100.1%	102
<i>Kreditë e retail - neto</i>	<i>76,929</i>	<i>88,823</i>	115.5%	11,895
Letrat me vlerë	54,104	49,234	91.0%	(4,870)
Asetet fikse (të prekshme dhe të paprekshme)	11,318	12,642	111.7%	1,324
Asetet tjera (neto)	1,108	1,134	102.3%	26
Detyrimet dhe Ekuiteti	464,095	463,501	99.9%	(594)
Burimet e sektorit bankar	6,346	3,645	57.4%	(2,701)
Depozitat nga bankat	866	1,015	113.9%	124
Huazimet	5,454	2,630	48.2%	(2,825)
Depozitat e sektorit jobankar	407,863	404,650	99.2%	(3,185)
Depozitat – korporatat	119,397	94,405	78.5%	(25,698)
Depozitat - retail	288,140	305,427	106.2%	17,776
Depozitat – shteti, të tjera	80	4,817	6021.3%	4,737
Detyrimet tjera	4,001	3,752	93.8%	(249)
Gjithsej kapitali/kapitali aksionar	45,913	51,454	112.1%	5,541
Kapitali	20,498	20,498	100.0%	-
Rezervat/provizionet (përfshirë edhe fitimin e pashpërndarë)	22,235	25,521	114.8%	3,286
Tjera	-106	0	0.0%	106
Fitimi/humbja për periudhën	3,286	5,435	165.4%	2,149

Bilanci i gjendjes - Bilanci i gjendjes i NLB Prishtina ka mbetur stabil dhe është forcuar më tej, dhe ka arritur në 463.5 milion EUR. Krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rënie për 0.6 milionë EUR (ose 0,1%). Plani vjetor është përbushur 111,6%. Struktura e Aseteve është përmirësuar duke reflektuar stabilitetin e Bankës. Rritja më e madhe ka qenë tek kreditë e klientëve.

Ilustrimi 2: Gjithsej Asetet 2012-2014 dhe struktura e asetëve



Paraja e gatshme dhe bilanci në Bankën Qendrore ka arritur në 66.3 milion EUR, ku ka shënuar rënie në krahasim me vitin paraprak për 30.9 milion EUR, për shkak të investimeve në asete më profitabile. Paraja e gatshme është shumë më lart sesa rezerva minimale e likuiditetit e kërkuar nga Banka Qendrore (rezervat e detyrueshme të likuiditetit).


Plasmanet në banka kanë arritur në 81.8 milion EUR, ku është shënuar rritje për 21.8 milion EUR (ose 36.3%). Të gjitha plasmanët janë në shtetet e OECD të cilat kanë klasifikim të lartë kreditor.

Letrat me vlerë AFS - kanë arritur në 49.2 milion EUR, një rënie prej 4.9 milion EUR (ose 9%). Të gjitha letrat me vlerë janë plasuar në Bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës, krahas investimit në Visa në shumë prej 176 mijë EUR (aksione të klasit C).

Neto kreditë e sektorit jobankar kanë shënuar rritje në 252.4 milion EUR, rritje për 12 milion EUR (ose 5%) në krahasim me vitin paraprak. Kreditë e sektorit jo-bankar kanë shënuar rritje në të gjitha llojet e kredive të lëshuara. Rritja është shënuar në Retail dhe Korporata. Struktura përbëhet nga kredi të korporatave 64,8% dhe kredi retail 35,2%.

Raporti i mbulueshmërisë së kredive me depozita (neto) e Sektorit Jo-Bankar (LTD) ka shënuar rritje në mënyrë të qëndrueshme në krahasim me vitin paraprak dhe është rritur në 62,4% (2013: 58,9%), si rezultat i rritjes së kredive dhe mbajtjes së depozitave në nivel të duhur dhe përmirësimin e cilësisë. Raporti i mbulueshmërisë së kredive me depozita (bruto) ka shënuar rritje në krahasim me vitin paraprak dhe është rritur në 69,6% (2013: 65,1%)

Ilustrimi 3: Gjithsej Neto kreditë (SJB)




Provizionet për humbjet nga kreditë - Banka ka vazhduar të ketë qasje konservative për krijimin e provizioneve për kredi dhe rezerva. Provizionet për kredit dhe avanset për klientët në vitin 2014 kanë shënuar rritje për 4,1 milion EUR dhe në fund të vitit kanë arritur në 29.1 milion EUR (2013: 25.2 milion EUR).

Raporti i kredive joperformuese i sektorit jobankar më 31 dhjetor 2014 ishte 7.7% (2013: 7.4%). Kreditë joperformuese (të Kategorisë D dhe E) të mbuluara me gjithsej provizione janë 132,7% (2013: 125,5%). Mbulesa e kredive bruto të sektorit jo-bankar me provizione është 10.3% (2013: 9.5%).

Gjithsej depozitat e sektorit jobankar kanë mbetur të qëndrueshme dhe kanë arritur në 404.7 milion EUR, në nivelin e përafërt të vitit paraprak. Rënia e shënuar ishte vetëm për 0,8% duke konsideruar rënien e madhe të normave të interesit të depozitave, klientët kanë vazhduar të ruajnë besimin e lartë në Bankë vit pas viti. Depozitat kanë vazhduar të dominohen nga klientët e Retail, ku struktura përbëhet nga 75,5% e depozitave të qytetarëve dhe 24,5% depozitat e personave juridik. Pjesëmarrja e tregut me depozitat ishte mbi 15 % në 2014.

Ilustrimi 4: Gjithsej Depozitat (SJB)



Burimet e huazuara kanë shënuar rënie në 2.6 milion EUR si rezultat i pagesës së kësteve të arritura. Të gjitha fondet e huazuara janë të pagueshme ndaj institucioneve financiare EFSE-KFW dhe të gjitha shumat do të shlyhen deri më 30 Shtator 2016.

Kapitali aksionar sipas IFRS ka arritur në 51.5 milion EUR. Kapitali i bankës ka shënuar rritje organike përgjatë viteve përmes kapitalizimit dhe fitimit të mbajtur. Fitimi për vitin 2014 sipas IFRS është 5.4 milion EUR.

6.2 Komentimi i bilancit të suksesit


NLB Prishtina ka shënuar performancë të mirë financiare duke tejkaluar objektivat e përcaktuara fillimisht dhe ka arritur fitim pas tatimit në shumë 5,435 mijë EUR (sipas standardeve lokale 5,400 mijë EUR). Neto fitimi ka shënuar rritje në krahasim me vitin paraprak dhe ka qenë më i lartë sesa plani vjetor, ku është arritur ROE a.t në 11.2% dhe ROA a.t, në 1.2% dhe më e lartë sesa në vitin paraprak.

Tabela 6.2.1. Bilanci i Suksesit - IFRS

000 EUR	2013	2014	Index
			2014 / 2013
Të hyrat operative	17,797	21,244	119.4%
Të hyrat neto nga interesi	14,021	17,816	127.1%
Të hyrat nga interesi	26,685	27,419	102.7%
Shpenzimet e interesit	(12,664)	(9,603)	75.8%
Të hyrat që nuk bartin interes dhe të hyrat/shpenzimet tjera	3,776	3,428	90.8%
Të hyrat nga komisionet (neto)	3,470	3,401	98.0%
Të hyrat nga komisionet dhe tarifat	4,436	4,558	102.7%
Shpenzimet për komisionet dhe tarifa	(966)	(1,157)	119.5%
Neto fitimi/humbja nga diferencat e kursit të këmbimit valutor	12	(169)	-
Neto fitimi/humbja nga asetet financiare në dispozicion për shitje.	377	383	101.6%
Fitimet/humbjet tjera neto operative	(83)	(187)	225.3%
Gjithsej shpenzimet operative	(10,016)	(10,379)	103.6%
Shpenzimet e stafit	(5,086)	(5,150)	101.3%
Shpenzimet dhe përgjithshme dhe administrative	(3,859)	(3,955)	102.5%
Zhvlrësimi / amortizimi	(1,071)	(1,274)	118.8%
Rezultatet financiare para provizioneve dhe tatimit	7,781	10,865	139.6%
Provizionet dhe rezervat	(4,082)	(4,733)	115.9%
Provizionet e kredive	(3,872)	(4,123)	106.5%
Provizionet për zërat jashtë bilancor	(2)	(9)	-
Zhvlrësimet/provizionet tjera	(211)	(601)	287.6%
Fitimi/humbja operative	3,699	6,132	165.8%
Shpenzimet e tatimit	(413)	(697)	168.8%
Neto fitimi/humbja për vitin financiar	3,286	5,435	165.4%

Të hyrat nga interesi neto, kanë arritur në 17,816 mijë EUR, ku është shënuar rritje për 3,795 mijë EUR në krahasim me vitin paraprak, që ka ardhur si rezultat i rritjes së portofolios kreditore dhe të hyrave më të larta nga interesi, mbajtja e depozitave në nivel të duhur (detyrimet që bartin interes më të ulta) dhe uljen e shpenzimeve të interesit (monitorimi efektiv i normave të interesit, shlyerja e huazimeve, etj). Marzha neto (interest margin) është përmirësuar në 4.2%, nga 3.7% sa ishte në vitin paraprak.


Ilustrimi 5: Të hyrat / shpenzimet nga interesi 2011-2014



Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet kanë arritur në 3,401 mijë EUR, dhe kanë shënuar rënie për 69 mijë EUR ose 2% në krahasim me vitin paraprak. Të hyrat nga tarifat dhe komisionet kanë shënuar rritje në 4,558 mijë EUR, rritje për 122 mijë EUR kryesisht rritja nga pagesat e transfereve/transaksione, kartelat dhe E-banking, ndërsa është shënuar rënie në të hyrat nga garancionet (si rezultat i rritjes së konkurrencës) që është neutralizuar me pagesa tjera. Në anën tjetër, shpenzimet nga komisionet dhe tarifat kanë shënuar rritje në 1,157 mijë EUR, rritje për 191 mijë EUR, kryesisht si rezultat i rritjes së pagesës për sigurimin e depozitave (pagesa në vitin aktual ka shënuar rritje për afro 115 mijë EUR, limiti i sigurimit ka shënuar rritje në 3,000 EUR).

Gjithsej shpenzimet operative – Banka ka vazhduar të përqëndrohet në menaxhimin e shpenzimeve duke operuar në mënyrë më efikase, duke përmirësuar proceset dhe kontrollat. Si rezultat, gjithsej shpenzimet operative kanë arritur në 10,379 mijë EUR, ku është shënuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin paraprak për 363 mijë EUR ose 3.6% duke pasur parasysh rritjen afariste, dhe si rezultat kryesisht nga kostot e larta të zhvlerësimit dhe të mirëmbajtjes (janë bërë investime të reja për të siguruar shërbime më të mira dhe më të besueshme), si dhe kosto të larta të stafit. Gjithsej shpenzimet operative ishin më të ulëta sesa Plani Vjetor për 371 mijë EUR ose 3.6%. Si rezultat i kontrollit efektiv të koston, dhe të hyrave operative neto më të larta gjatë vitit, raporti i CIR është përmirësuar edhe më tej në 48.9% (2013: 56.3%).

Ilustrimi 6: Shpenzimet operative për periudhën 2011-2014



Shënim, detajet e politikave të kontabilitetit në bazë të cilave janë përgatitur pasqyrat financiare janë paraqitur në shpalljet e pasqyrave financiare të raportit të auditorit në këtë raport.

7. Aktivitetet sipas segmenteve afariste

7.1 Afarizmi me personat juridik

Klientët e korporatave të NLB Prishtina shërbehen në 47 degë, ekspozitura dhe terminale doganore. Në vitin 2014 Banka ka vazhduar të ndërtojë marrëdhënie të forta me klientët e korporatave duke ofruar një shumëllojshmëri të shërbimeve dhe menaxhimin e rritjes së mëtejshme të pozicionit të Bankës në segmentin e korporatave.



Aktivitetet afariste me personat juridik paraqesin pjesën më të madhe të aktiviteteve të Bankës dhe përfaqësojnë një pjesë të lartë të rritjes totale. Ato përfshijnë kreditë afat-shkurtra për nevojat aktuale, linjat kreditore, mbitërheqjet, kreditë afatgjate për financimin e projekteve të investimeve, kreditë për ndërtimin e objekteve afariste, letër kreditë dhe garancionet, aktivitetet e depozitimit, shërbimet e transaksioneve të pagesave vendore dhe ndërkombëtare. Gjatë vitit 2014, Banka u ka shërbyer më shumë se 14 mijë klientëve të korporatave, duke filluar nga industri të ndryshme, përfshirë kompanitë ndërkombëtare dhe institucionet financiare. Duke kombinuar ekspertizën e tregut vendas me njohuritë ndërkombëtare të Grupit NLB, NLB Prishtina tashmë ka arritur një reputacion për një koncept të sofistikuar për personat juridikë. Banka gjithashtu ka siguruar optimizimin e profilit të riskut duke monitoruar në mënyrë të afërt portofolion kreditore duke u përqendruar në mënyrë qendrore në ruajtjen e një portfolio cilësore kreditore, në të njëjtën kohë duke arritur një rritje të portofolios përmes marrëveshjeve të reja.

Ofertat bankare për subjektet juridike janë zhvilluar duke respektuar modelin e menaxhimit të integruar të marrëdhënieve me klientë, veçanërisht për klientët e korporatave më të mëdha, si edhe plotësimin e nevojave të klientit

Table 7.1.1. Të dhënat kryesore të aktiviteteve bankare me korporata

000 EUR	2012	2013	2014	Index	
				2014 / 2012	2014 / 2013
Shuma e kredive të korporatave (neto)	155,860	163,440	163,541	104.9%	100.1%
Shuma e depozitave të korporatave	123,692	119,615	94,405	75.9%	78.5%
Numri i klientëve	20,129	15,293	14,707	73.1%	96.2%
Numri i kartelave (debitore)	9,222	6,191	4,968	53.9%	80.2%
Numri i E-banking	1,828	2,172	2,764	151.2%	127.3%

Ilustrimi 7: Trendi i kredive dhe depozitave të korporatave për periudhën



Në fushën e aktiviteteve depozituese, aktivitetet kanë qenë të drejtuara në menaxhimin dhe mbajtjen e depozitave në nivelet optimale dhe kualitative në përputhje me orientimet strategjike të bankës dhe si rezultat, është bërë optimizimi i depozitave në shumën prej 94 milion EUR.

7.2. Afarizmi me retail

Aktivitetet kryesore në Retail kanë qenë të fokusuar në arritjen e rritjes të afarizmit siç përcaktohet nga objektivat kryesore të bankës dhe arritjen e standardeve të Retailit sipas NLB, bazuar në përvojat dhe rekomandimet e NLB d.d. Sllovenia, në fushën e shërbimeve dhe produkteve për klientët individualë, si dhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).



Optimizimi i rrjetit afarist të NLB Prishtina, e cila ka një rrjet të gjerë të degëve, që i ofron klientëve të saj qasje të thjeshtë dhe miqësore në produktet bankare. NLB Prishtina gjatë vitit 2014 është fokusuar kryesisht në forcimin e aftësive dhe kompetencave të stafit në degë në mënyrë që të sigurojë këshilla më komplekse financiare dhe zgjidhje për nevojat e klientit. Përveç kësaj, NLB Prishtina ka investuar një kohë të konsiderueshme në kujdesin ndaj klientëve. Viti 2014 ishte një vit i zhvillimit dhe përmirësimeve në lokalet e degëve dhe Banka ka modernizuar rrjetin e IT.

NLB Prishtina është e pranishme në tërë territorin e Kosovës, në 9 rajone të mëdha, me praninë e saj në 47 lokacione dhe 61 Bankomate/ATM të vendosura në të gjitha njësitë e Bankës dhe në vendet më të frekuentuara. Më shumë se gjysma e njërive të NLB Prishtina (rreth 71%) janë rinovuar në përputhje me standardet e NLB d.d. ndërsa të gjitha shërbimet bankare dhe produktet e ofruara janë të fokusuar në nevojat e klientëve për shërbime bankare të sigurta dhe moderne.

Tabela 7.2.1. Të dhënat e aktiviteteve të Retail

000 EUR	2012	2013	2014	Index	
				2014 / 2012	2014 / 2013
Shuma e kredive retail (neto)	78,278	76,929	88,824	113.5%	115.5%
Shuma e depozitave të retail	243,429	288,140	305,427	125.7%	106.2%
Numri i klientëve	241,405	226,713	241,148	99.9%	106.4%
Numri i kartelave (debitore)	53,744	57,007	67,057	124.8%	117.6%
Numri i kartelave (kreditore)	1,745	2,009	2,350	134.7%	117.0%
Numri i E-banking	4,250	5,001	6,341	149.2%	126.8%

Ilustrimi 8: Trendi i kredive dhe depozitave me Retail



Afarizmi me kanalet moderne të shpërndarjes

Kanalet moderne të shpërndarjes kanë vazhduar të zhvillojnë shërbime të reja dhe të konsolidojnë ato ekzistuese. Në janar të vitit 2015 NLB Prishtina ka vendosur në funksion shërbimin ATM depozitor.

NLB Prishtina ka lansuar një produkt të ri të kartelës kreditore që është e dedikuar për klientët të cilët kanë Depozita të afatizuara (MasterCard TDA). Ajo siguron përfitime për klientët që dëshirojnë të bëjnë blerje dhe në anën tjetër të dëshirojnë të ruajnë depozitat e tyre. Ekziston një trend pozitiv i vazhdueshëm në rritjen e numrit të përdoruesve të rinj dhe aktiv të bankingut elektronik (e-click) në të dy segmentet, retail dhe korporata. Zhvillimi i shërbimeve të reja brenda E-Klik do të mundësojë rritjen e përdoruesve aktiv që do të lehtësojë të gjitha nevojat e klientëve.

Afarizmi me kreditë e personave fizik (retail) - Afarizmi me kreditë e retail, gjatë vitit 2014 ka qenë shumë i suksesshëm, sidomos kreditë për personat fizik. Gjatë këtij viti Retail ka shënuar rritje të konsiderueshme si në numër ashtu edhe në shuma. Krahasuar me vitin 2013, portofolio kreditore ka shënuar rritje me rreth 12,5 milion EUR ose 14,1% (bruto). Portofolio kreditore e retail me 31 Dhjetor, 2014 ishte 89 milion EUR (net). Rreth 93,3% e totalit të portofolios kreditore mbetet në kategorinë A.

Afarizmi me depozitat e retail - mbetet një ndër aktivitetet themelore tradicionale të Bankës. Depozitat e personave fizik gjatë vitit 2014 kanë shënuar rritje për 6 %, duke arritur në total 306 milion EUR, ose një rritje prej 17.3 milion EUR krahasuar me vitin paraprak.

Shërbimi i bankingut personal - është një shërbim i përshtatur që i ofrohet klientëve kyc dhe shumë kërkues të Bankës. Zhvillimi i këtij shërbimi ka qenë një prioritet i segmentit Retail të Bankës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore për klientët e përzgjedhur dhe prestigjioz. Pako e dizajnuar për këtë kategori ka rritur numrin e klientëve në këtë kategori. Në vitin 2014 numri i klientëve të cilët kanë përfituar nga shërbimi i Bankingut Personal është rritur në 2,337 (në vitin 2013 ka qenë 1,906)

7.3. Thesari dhe pagesat

Menaxhimi i Pasurive dhe Detyrimeve

Depozitat e retail kanë mbetur burimi kryesor i qëndrueshëm i financimit për Bankën pavarësisht nga normat historikisht të ulëta të interesit në 2014. Në mënyrë që ti përgjigjet mjedisit dinamik të çmimeve, Banka e ka rishikuar rregullisht Politikën e saj të Çmimeve për depozitat dhe kreditë e klientëve.

Menaxhimi i likuiditetit

Gjatë vitit 2014 NLB Prishtina ka vazhduar të ruajë nivelet e mjaftueshme të likuiditetit me limitime në investime në mjedisin ndërkombëtar që vazhdon të jetë i tensionuar. Banka në mënyrë të suksesshme ka menaxhuar likuiditetin dhe ka siguruar pajtueshmëri me të gjitha provizionet në pajtim me Rregulloret e Bankës Qendrore, Udhëzimet dhe Metodologjinë e Grupit NLB, si dhe kalkulimet preliminare të standardeve globale të likuiditetit- Raportet e Basel III. Poashtu më 2014 NLB Prishtina gjithashtu ka qenë shumë aktive në tregun lokal dhe ka hapur kapitull të ri të bankës në Tregut e Letrave me vlerë të Kosovës duke bërë marrëveshjen e parë në tregun sekondar të Kosovës me Ndërmarrjen publike të Telekomit.

Gjatë vitit 2014, në bazë të Udhëzimeve të Grupit NLB, Banka ka vazhduar të aplikojnë metoda matëse, monitoruese dhe menaxhuese, projeksione të rregullta të likuiditetit dhe stres skenarë në bazë të skenarëve të ndryshëm të supozimeve realiste dhe negative. Banka ka qenë në përputhje me limitet e sipërme të përcaktuara nga metodologjia e aprovuar rishtas të Analizës së vlerësimit kreditor dhe klasifikimin bazuar në klasifikimin ekzistues kreditor nga agjencione ndërkombëtare të vlerësimit kreditor dhe metodologjinë e brendshme të NLB.

Tregu i këmbimeve valutore dhe Sistemi I Pagesave

NLB Prishtina është e vetmja bankë në Kosovë që ofron këmbime kreditore në 9 (nëntë) valuta likuide – USD, CHF, GBP, NOK, SEK, AUD, CAD, HRK dhe DKK.

Në vitin 2014 Bankat e Kosovës kanë filluar përgatitjen për standardizimin e numrave të llogarive me standardet IBAN, të cilat kanë përmirësuar më tej besueshmërinë dhe efikasitetin e pagesave ndërkombëtare. Në mënyrë që të zvogëlojë kostot e pagesave të klientëve, gjatë vitit 2014 NLB Prishtina ka zbatuar tarifën më të ulët për pagesat në rajon. Për të siguruar proces të qetë të pagesave të pensioneve, Banka ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Mirëqenies Sociale që u ka mundësuar pensionistëve për të tërhequr pensionet me kartela debitorë. Në fushën e transaksioneve të pagesave vendore, në 2014, më shumë se 2 milion pagesa janë procesuar, si dhe është regjistruar një qarkullim total prej 1,94 mil. EUR, ose 8,76% më shumë se në vitin 2013. Më poshtë janë paraqitur shumat e pagesave vendore dhe numri i pagesave ndërkombëtare.

Biznesi dokumentar

Gjatë vitit 2014, banka ka mbështetur tregtinë lokale dhe ndërkombëtare të klientëve duke lëshuar të gjitha llojet e Letërgarancioneve, letërkredive, Letrat Qëllimore dhe llogaritë e dorëzanisë, si dhe pranimin e çeqeve për arkëtime, duke qenë ndër bankat e vetme të Kosovës që e pranon këtë produkt që është në ulje e sipër të përdorimit si instrument i pagesës; Shuma totale e garancioneve dhe Letërkredive më 31 dhjetor 2014 ka arritur shumën 21,524 mije EUR.

7.4. Teknologjia informative

INë vitin 2014 NLB Prishtina ka vazhduar me investime të konsiderueshme në fushën e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit duke vendosur kështu një infrastrukturë të fortë për të arritur përfitime, duke kontribuar në përmirësimin e kualitetit të shërbimeve ndaj klientit dhe duke siguruar një infrastrukturë teknike të plotë, fleksibile dhe të modernizuar.

Në mënyrë që të sigurohet një kthim efikas në rast të katastrofave, Divizioni i IT-së ka vazhduar të përcjell procesin e shqyrtimit të Planit për Vazhdimësinë Afariste (BCP) dhe Procedurat për Rimëkëmbje duke zhvilluar teste tremujore sipas planeve të përcaktuara në fillim të vitit kalendarik. Lidhur me këtë, në vitin 2014 planet për vazhdimësinë afariste (BCP) pothuajse për të gjitha aplikacionet kritike afariste janë testuar me sukses duke siguruar disponueshmërinë e lartë të shërbimeve ndaj klientëve të bankës.

Përveç kësaj, me qëllim të arritjes më të shpejtë të Objektivave për kthim në kohë (RTO – Recovery Time Objectives) dhe në këtë mënyrë duke siguruar vazhdimësinë e biznesit, TI ka zbatuar një zgjidhje të gjeneratës së re për mbrojtjen e të dhënave që përdor teknologji të ofruar nga softweri për backup dhe kthim EMC Networker i integruar në sistemin e të dhënave EMC Data Domain. Duke zvogëluar madhësinë e backup datasets, tani backup mund të ruhen më gjatë onsite për rikthim të shpejtë operacional dhe përsëriten offsite në mënyrë efikase mbi lidhjet ekzistuese të rrjetës për qëllime të kthimit apo rimëkëmbjes nga fatkeqësitë.

Gjatë vitit 2014, Divizioni i Teknologjisë Informative të Bankës ka qenë mjaft i përfshirë në përmirësimin e afarizmit me kartela dhe produktet elektronike bankare të ofruara nga banka.

Në mënyrë që klientit t'i ofrohet shërbim më i shpejtë është modifikuar softweri bazë i bankës në atë mënyrë që disa nga proceset janë automatizuar si normat kamatore për depozita të afatizuar, normat kamatore për kredi, njoftimi përmes mesazhit SMS, njoftimet përmes e-mailit etj.

Pothuajse të gjitha modulet në softwerin bazë të bankës janë modifikuar gjatë vitit 2014 në mënyrë që të lëhtësohen operacionet në fushën e shërbimit të klientëve (Front office) dhe është rritur efikasiteti i shërbimeve ndaj klientëve.

DMS - IT në koordinim me anën afaristet rregullisht identifikojnë komponente të reja potenciale që ndihmojnë në përmirësimin e shërbimit.

IT do të vazhdoj ngritjen e infrastrukturës së bankës të nevojshme për të mbështetur operacionet bankare duke mundësuar bankës kërkimin e mundësive të reja afriste duke ofruar zgjidhje dhe shërbime të përbalueshme, të besueshme dhe të sigurta për klientët e saj.

8. Menaxhimi i Riskut

Në mjedisin e tanishëm vendor dhe trendet globale të industrisë financiare, Departamenti i Riskut të NLB Prishtina ka një rol kyç në operacionet e përditshme bankare duke aplikuar qasje konzerervative të menaxhimit të riskut. Në mënyrë të ngjashme, aktivitetet e menaxhimit të riskut janë zgjeruar nga përfshirja e mëtejshme e Departamentit në procesin strategjik të vendim-marrjes, duke shtuar gjithashtu vlerën dhe ndërgjegjësimin ndaj riskut në fushat si çmimvënia dhe zhvillimi i produktit. Kështu, roli kryesor i departamentit të menaxhimit të riskut është reflektimi dhe zbatimi i apetitit të riskut të grupit NLB, në drejtim të specifikave të tregut vendor, me një objektivi të vetëm drejt kontributit dhe mbajtjes së menaxhimit efektiv të kualitetit të aseteve.

Funksioni i menaxhimit të riskut të NLB Prishtina siguron që risku kreditor, risku i tregut, risku i likuiditetit, risku i investimeve, duke përfshirë riskun operacional janë identifikuar në mënyrë efektive, në baza të rregullta, të matura, të monitoruara dhe kontrolluara në mënyrë që të zvogëlohet risku.

Risku operacional - Qëllimi i menaxhimit të riskut është të menaxhojë ekspozimin ndaj riskut operacional dhe të zvogëlojë humbjet potenciale që mund të ndodhin për shkak të sistemeve të brendshme jo-adekuate, procesin e kontrollit, dobësitë dhe dështimet gjatë procesit të punës, aktiviteteve ilegale dhe ngjarjet e jashtme të cilat mund shkaktojnë humbje për bankën. Për të mundësuar një sistem të shëndoshë të menaxhimit të riskut NLB Prishtina ka krijuar strukturat e duhura (Komiteti i menaxhimit të riskut operacional) dhe ka caktuar përgjegjësitë në kuadër të strukturës organizative të bankës për të siguruar identifikimin efikas të riskut, regjistrimin, zvogëlimin dhe monitorimin e riskut operacional. Në të njëjtën kohë, ngjarjet e dëmshme si pasojë e riskut operacional janë përcjellur në baza mujore, në mënyrë aktive janë monitoruar dhe raportuar tek organet e brendshme të NLB Prishtina.

Detajet për Menaxhimin e riskut duke përfshirë riskun kreditor, riskun e likuiditetit, riskun e normës së interesit, riskun e menaxhimit të kapitalit, etj, janë paraqitur në seksionin e Shpalosjes (31) në seksionin e menaxhimit të riskut të pasqyrave financiare të audituara.

9. Përgjegjësia sociale e korporatës

NLB Prishtina merret me aktivitete të cilat janë në përputhje me Politikën Sociale dhe të Ambientit të Bankës sonë dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për përgjegjësitë e përbashkëta sociale, dhe i zhvillon ato.

Ne fuqimisht besojmë se duke qenë ekonomisht të suksesshëm dhe konkurrues gjenerojmë vlera për të gjithë akteret tanë, duke përfshirë aksionarët e Bankës, klientët, të punësuarit, si dhe të gjithë shoqërinë. Ne vazhdojmë të aplikojnë standarde të larta mjedisore dhe sociale në afarizmin bankar për të mbështetur një të ardhme të qëndrueshme.

Progresi dhe prosperiteti janë shtyrje gjatë inicimit dhe mbështetjes së projekteve arsimore sociale dhe kulturore që i ndihmojnë njerëzit për të përmbushur dhe për të arritur qëllimin e tyre

9.1. Aktivitetet sociale dhe të ambientit

Banka aplikon parimin e trajtimit të drejtë me mundësi të barabarta për të gjithë të punësuarit në bankë. Banka vazhdon të ketë strukturën e balancuar të të punësuarëve të gjinisë femërore dhe atyre mashkullore.

Në vitin 2014, Banka ka bërë përpjekje për të ngritur njohuritë e të punësuarëve të saj përmes seminareve të ndryshme, trajnimeve, praktikave më të mira dhe përvojat nga bankat e NLB Group. Banka gjithashtu ka ofruar ndihmë financiare brenda kapaciteteve të saj për studim dhe zhvillim profesional në Kosovë dhe jashtë Kosovës në mënyrë që të mbajë një standard të lartë të shërbimeve të ofruara për të gjithë akterët e saj.

Banka në vitin 2014 ka nënshkruar prapë kontratën me kompaninë e siguimit shëndetësor për sigurimin e të punësuarve të bankës, dhe kjo polisë mbulohet nga banka në emër të punësuarve të saj.

Me qëllim të aftësisht profesional në praktikë, Banka ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me disa fakultete për pranimin e studentëve për vijimin e mësimi praktik në bankën tonë, si dhe në mënyrë individuale në bazë të kërkesave të studentëve, e cila është një praktikë për shumë vite.

Të punësuarit e NLB Prishtina janë të përfshirë në mënyrë aktive në fushatat humanitare edhe jashtë obligimeve të tyre të përditshme në punë dhe përmes iniciativës së tyre kanë kontribuar në përgjegjësinë sociale duke:

- Pastruar mjedisin
- Mbledhur kontribute vullnetare nga të punësuarit për personat me aftësi të kufizuara dhe ata të sëmurë
- Mbledhjen e kapakave të shisheve të plastikës për qëllime bamirëse,
- Pjesëmarrja në fushatat e dhurimit të gjakut dhe
- Pjesëmarrja në fushatat e tjera të ndryshme.

Banka ka marrë pjesë dhe ka mbështetur si sponsor apo ka marrë pjesë në iniciativa/aktivitete të ndryshme sociale si Fushata me titullin "Të pastrojmë Kosovën", aktivitetet financiare, donacionet për fushatën e organizuar për "nënë dhe fëmijën", donacion për Handikos, etj

NLB Prishtina gjatë vitit 2014 ka sponsorizuar klube të ndryshme si: klubi i futbollit Prishtina, federatat e shahut të Kosovës, etj

Për mbështetjen e vazhdueshme të Odës Ekonomike Amerikane, NLB Prishtina është shpërblyer me certifikatë falenderimi

10. Burimet njerëzore

NLB Prishtina në mënyrë të vazhdueshme edhe në vitin 2014 ka pasur qëllim të qartë për zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Kjo është e bazuar në parimin se konceptet moderne të menaxhimit të burimeve njerëzore nënkuptojnë menaxhimin e kompetencave, kënaqësinë e klientit nga shërbimet e ofruara dhe përgjegjësinë e të punësuarve. Si në çdo institucion, edhe në Bankë, menaxhimi i burimeve njerëzore ka qenë dhe ende është funksioni më i rëndësishëm.

Trendet e zhvillimit që karakterizojnë ditët e sotme, tregojnë se shoqëria do të bazohet në vlerat e reja, të cilat janë në thelb vlera jo-materiale, në radhë të parë njohuri, informacione, ide të komunikimit dhe inteligjencë të burimeve njerëzore. Prandaj, Banka në vitin e kaluar ka bërë përpjekje për të inkurajuar të punësuarit për të marrë pjesë në trajnime të brendshme, të jashtme, sesione dhe takime të punës në mënyrë që të ndihmojë në rritjen e profesionalizmit në performancën e çfarëdo funksioni, zhvillimin e një kulture të re të bashkëpunimit, këmbimit të përvojës së punës në mes tyre, zhvillimin e marrëdhënieve jo vetëm hierarkike, por edhe me qytetarët, në mënyrë që secili prej tyre veç e veç, por edhe së bashku do të kontribuojnë drejt arritjes së objektivave afariste.

Ngjarja më e veçantë që ka ndodhur në vitin 2014 ishte që Banka për herë të parë në bashkëpunim me NLB dd, me institucione të specializuara si HSC, ADECC, etj, ka organizuar teste për të punësuarit në pozita menaxheriale për mëenaxhimin e kompetencave, kompetencave sociale dhe testimin interaktiv (Qendra e Vlerësimit), të cilët janë testuar për inteligjencën e përgjithshme dhe verbale, aspiratat e karrierës, llojet e personalitetit dhe vlerësimin e kompetencave.


Në bankë janë 287 të punësuar të gjinisë femërore dhe 238 të gjinisë mashkullore.

Tabela 10.1: Struktura sipas moshës dhe shkollimit

Moshë sipas viteve	NUMRI			
	2011	2012	2013	2014
Deri 30 vjet	164	142	117	83
Prej 31 dero 40 vjet	172	189	209	233
Prej 41 deri 50 vjet	82	83	83	89
Prej 51 deri 60 vjet	90	93	92	87
Mbi 60	20	22	24	33
TOTAL	528	529	525	525

Edukimi	Numri			
	2011	2012	2013	2014
Më pak se shkolla e lartë	11	10	8	8
Shkolla e lartë	254	253	248	243
Kolegj	33	33	31	30
Universitet	218	215	216	221
Masters dhe PHD	12	18	22	23
TOTAL	528	529	525	525

Ilustrimi 9: Numri I të punësuarve.




11. Qeverisja Korporative

11.1. Qeverisja Korporative dhe Organet Menaxhuese

NLB Prishtina ka një strukturë të qartë organizative që saktësisht përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe organeve të tjera të menaxhimit, të punësuarit e tjerë, si dhe të linjave të kontrollit dhe të kontrolleve në kryerjen e detyrave të përditshme.

Struktura organizative e NLB Prishtina është si më poshtë:



Banka menaxhohet nga Bordi Udhëheqës dhe mbikëqyret nga Bordi i Drejtorëve.

Organet kryesore të Bankës janë:

- Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve,
- Bordi i Drejtorëve
- Komiteti i Auditimit
- Komiteti i Menaxhimit të Riskut
- Bordi Udhëheqës i Bankës
- Organet tjera operative

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të NLB Prishtina organizohet dhe merr vendime në takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme, ku miraton vendimet në përputhje me ligjin. Përgjegjësitë e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve të NLB Prishtina janë të përcaktuara me Statutin e NLB Prishtina, të cilat janë gjithashtu në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga rregullatori.

Gjatë vitit 2014, është mbajtur një Mbledhje e Përgjithshme e Aksionarëve. Mbledhja është mbajtur me datë 30 Mars 2014 dhe ishte mbledhje e rregullt e aksionarëve për vitin 2014. Në mbledhje prezent ishin 89,39% e aksionarëve. Në mesin e punëve tjera të rregullta, në këtë mbledhje të përgjithshme të aksionarëve janë aprovuar edhe këto dokumente: Raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 2013, Plani afarist për periudhën 2014-2018, caktimi i auditorit të jashtëm për vitin 2014 si dhe ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të NLB Prishtina sh.a.

Kapitali aksionar

Kapitali i autorizuar aksionar i Bankës më 31.12.2014 përbëhej nga 42,739 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 479,61 EUR për aksion. Aksionet nominale i përcaktojnë pronarëve të drejtën mbi pagesën e dividendës dhe të drejtën e votës në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve. Kapitali i autorizuar aksionar i Bankës përfaqëson të gjithë kapitalin aksionar të paguar. Gjithsej kapitali i regjistruar ishte 20,498 mijë EUR, ndërsa gjithsej kapitali aksionar më 31 dhjetor 2014 ishte 51,454 mijë EUR (2013: 45,913 mijë EUR).

Aksionari më i madh i NLB Prishtina është NLB d.d. me 81.21%, ndërsa të dhënat më të detajuara janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare të audituara në kuadër të këtij raporti.

Përbërja e Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve zgjidhet nga aksionarët Bankës, në Mbledhjen e Përgjithshme vjetore të Aksionarëve dhe është përgjegjës pos tjerash edhe për krijimin e politikave, duke përfshirë politikat për menaxhimin e riskut dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Bordi i Drejtorëve kryen detyrat në përputhje me dispozitat e ligjeve mbi qeverisjen bankare dhe Statutin e Bankës të NLB Prishtina sh.a.

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2014 ka mbajtur 5 mbledhje.

Më datë 31 dhjetor 2014, struktura e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të NLB Prishtina sh.a. ishte si në vijim:

- Janko Medja, kryetar
- Jure Peljhan, nënkryetar
- Andrej Baricic, anëtar
- Aleksander Vozel, anëtar
- Ardiana Bunjaku, anëtar
- Albert Lumezi, anëtar – Kryetar i Bordit Udhëheqës të NLB Prishtina sipas funksionit pa të drejtë vote

Bordi i Drejtorëve i NLB Prishtina ka themeluar Komitetin e Auditimit ashtu siç është kërkuar nga ligji mbi bankat.

Anëtarët e Komitetit të Auditimit me datë 31 dhjetor 2014, ishin:

- Andrej Baricic, Kryetar i Komitetit të Auditimit
- Leon Živec, anëtare e Komitetit të Auditimit
- Ardiana Bunjaku, anëtare e Komitetit të Auditimit

Më datë 31 dhjetor 2014, anëtarët e Komitetit të Riskut ishin:

- Aleksander Vozel, Kryetar
- Jure Peljhan, anëtar
- Ardiana Bunjaku, anëtar

Përbërja e Bordit Udhëheqës të Bankës

Bordi Udhëheqës i NLB Prishtina udhëheq, përfaqëson dhe vepron në emër të Bankës, në mënyrë të pavarur dhe me vetë-përgjegjësi, ashtu siç parashihet me Statutin e Bankës. Kryetari dhe anëtarët emërohen me një mandat prej katër vitesh, dhe mund të riemërohen ose të tërhiqen para skadimit të mandatit në përputhje me Ligjin dhe Statutin e Bankës.

Bordi Udhëheqës i NLB Prishtina përbëhet nga tre persona: z. Albert Lumezi, Kryetar i Bordit Udhëheqës, z. Bogdan Podlesnik, anëtar i Bordit Udhëheqës dhe z. Lavdim Koshutova, anëtar i Bordit Udhëheqës.

Me qëllim të sigurimit të funksionimit të duhur të afarizmit të Bankës si dhe monitorimin e aktiviteteve të rregullta, brenda Bankës gjithashtu veprojnë këto këshille/komitete:

- Komitetit për menaxhimin e Aktives dhe Pasives (ALCO)
- Komiteti kreditor
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Kreditor
- Komiteti i Sigurisë
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Operacional
- Komiteti i IT-së
- Komiteti i Personelit
- Komiteti i Prokurimit

Në kuadër të Komitetit të ALCO-s është edhe komiteti i çmimeve.

11.2. Auditimi i brendshëm

Sektori i Auditimit të Brendshëm të NLB Prishtina është Sektor i Pavarur , i cili funksionon në një rol këshillues të pavarur dhe objektiv, duke përdorur një qasje sistematike dhe profesionale për të vlerësuar menaxhimin e riskut, sistemin e kontrollit të brendshëm dhe efikasitetin e operacioneve të Bankës. Auditimi i brendshëm jep një kontribut të rëndësishëm për Bankën për të përmbushur objektivat e saj strategjike dhe afariste dhe për të aplikuar praktikatat më të mira bankare.

Metodologjia e punës së Auditimit të Brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në Statutin e Auditimit, ndërsa udhëzimet dhe procedurat e punës janë të përshkruara në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Të dyja këto dokumente janë plotësisht në përputhje me standardet e Qendrës së Auditimit të Brendshëm të NLB d.d., praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe në përputhje me ligjin bankar në Kosovë.

Auditimi i brendshëm i NLB Prishtina funksionon dhe është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm dhe Auditorët e Brendshëm vepronë në përputhje të plotë me Kodin e Etikës së auditimit të brendshëm.

Gjate vitit 2014 auditimi i brendshëm i bankës ka kryer punën sipas Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2014. Bazuar në planin e auditimit, janë kryer dymbëdhjetë (12) auditime të rregullta që mbulojnë fushat kryesore të afarizmit të bankës duke përfshirë riskun kreditor, kontabilitetin dhe financat, bankingun personal, e-banking, afarizmin me kartela, funksionin e teknologjisë informative, parandalimi i shpërlarjes së parave (AML), kreditë e korporatave si dhe tri (3) auditime të pa-paralajmëruara të degëve. Tri auditime janë kryer në bashkëpunim me Qendrën nga Auditimi i Brendshëm i NLB d.d. Ljubljana.

Përveç kësaj, Auditimi i Brendshëm rregullisht ka monitoruar implementimin e rekomandimeve të lëshuara nga Banka Qëndrore e Kosovës, Auditori i Jashtëm dhe Shërbimi i Auditimit të Brendshëm. Statusi i rekomandimeve të hapura është raportuar në baza tremujore në Këshill të Auditimit, Bord të Drejtorëve, Bord Udhëheqës dhe Qendrën për Auditim të Brendshëm të NLB d.d.

12.

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit

NLB PRISHTINA SH.A.

**Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

PËRMBAJTJA	FAQE
DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT	3
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	4-5
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE	6
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	8
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	9
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	10 - 78

DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT

Për aksionarët dhe bordin e drejtorëve të NLB Prishtina sh.a.

Bordi Udhëheqës konfirmon përgjegjësinë e tij për përgatitjen e pasqyrave financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, dhe për politikat që shoqërojnë kontabilitetin dhe shënimet e pasqyrave financiare.

Bordi Udhëheqës është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për të dhënë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të Bankës më 31 dhjetor 2014 rezultatet financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar.

Bordi Udhëheqës gjithashtu konfirmon se politikat e duhura kontabël janë aplikuar në mënyrë konsistente dhe se vlerësimet e kontabilitetit janë përgatitur në përputhje me parimet e kujdesit dhe menaxhimit të mirë. Bordi udhëheqës më tej konfirmon se pasqyrat financiare të Bankës, së bashku me shënimet shpjeguese, janë përgatitur në përputhje me parimin e vazhdueshmërisë së operimit të biznesit dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Bordi Udhëheqës është gjithashtu përgjegjës për praktikën e përshtatshme kontabël, për miratimin e masave të përshtatshme për ruajtjen e asetëve, dhe për parandalimin dhe identifikimin e mashtrimit dhe parregullsive të tjera ose akteve të paligjshme.

Prishtinë, Kosovë
30 janar 2015

Bordi Udhëheqës



Lavdim Koshutova
Anëtar i Bordit-Udhëheqës



Bogdan Podlesnik
Anëtar i Bordit Udhëheqës



Albert Lumezi
Kryetar i Bordit Udhëheqës

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Drejtorët e Bordit të NLB Prishtina sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkangjitura të NLB Prishtina Sh.a. ("Banka") të cilat përbehen nga pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2014, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar dhe një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme të përcaktuara nga menaxhmenti si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimet apo gabimet.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi të mjaftueshme për vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorëve, duke përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të njësisë ekonomike në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të Bankës më 31 dhjetor 2014, performancës së saj financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështjet e tjera

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013 janë audituar nga një auditor tjetër i cili shprehu një opinion të pakualifikuar për ato pasqyra më 21 shkurt 2014.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k
Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k

**Prishtinë,
23 shkurt 2015**

NLB PRISHTINA SH.A.
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
PASURITË			
Paraja dhe gjendja me Bankën Qëndrore	4	66,282	97,163
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	81,844	60,034
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	252,365	240,368
Pasuritë financiare në dispozicion për shitje	8	49,234	54,104
Pasuritë tjera	9	670	549
Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat	25	256	230
Prona dhe pajisjet	10	12,160	10,756
Pasuritë e paprekshme	11	482	562
Tatimi i shtyrë	25	208	329
Gjithsej pasuritë		463,501	464,095
DETYRIMET			
Detyrimet ndaj bankave	12	1,015	866
Detyrimet ndaj klientëve	13	404,650	407,863
Detyrimet tjera financiare	14	2,442	3,218
Detyrimet tjera	15	1,310	781
Huamarrjet	16	2,630	5,454
Gjithsej detyrimet		412,047	418,182
EKUITETI			
Kapitali aksionar	17	20,498	20,498
Rezerva e ri-vlerësuar për letrat me vlerë	8	-	(106)
Fitimi i pashpërndarë		30,956	25,521
Gjithsej ekuiteti		51,454	45,913
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		463,501	464,095

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Bordi Udhëheqës më 30 janar 2015 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:



Z. Albert Lumezi
 Kryetar i Bordit Udhëheqës



Z. Bilall Hoti
 Drejtor Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 10 deri 78 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB PRISHTINA SH.A.
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2014	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2013
Të hyrat nga interesi	18	27,419	26,685
Shpenzimet e interesit	19	(9,603)	(12,664)
Të hyrat neto nga interesi		17,816	14,021
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	20	4,558	4,436
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	21	(1,157)	(966)
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet		3,401	3,470
Shpenzimet e zhvlerësimit për humbjet nga kreditë	6	(4,109)	(3,871)
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet		17,108	13,620
Neto fitimi nga këmbimet në valuta të huaja		214	382
Te hyrat nga instrumentet financiare te Ekuitetit	8	181	-
Të hyrat/shpenzimet tjera operative	22	(368)	(76)
Humbjet dhe provizionet tjera për zhvlerësim	7	(624)	(211)
Shpenzimet e personelit	23	(5,150)	(5,086)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	10,11	(1,274)	(1,071)
Shpenzimet administrative dhe të tjera operative	24	(3,955)	(3,859)
Fitimi para tatimit		6,132	3,699
Tatimi në fitim	25	(697)	(413)
Neto fitimi për vitin		5,435	3,286
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse /(humbja):			
Neto (humbjet)/fitimi nga ndryshimi i vlerës reale të AFS letrave me vlerë	26	106	(347)
Gjithsej të hyrat gjithpërfshirëse për vitin		5,541	2,939
Fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion (në Euro për aksion)	27	127.3	76.9

Shënimet shpjeguese nga 10 deri 78 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB PRISHTINA SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rivlerësimi i rezervës për AFS letrat më vlerë	Fitimi i mbajtur	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2013	20,498	241	22,235	42,974
Neto fitimi për vitin	-	-	3,286	3,286
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse (humbjet)	-	(347)	-	(347)
Gjithsej të hyrat gjithpërfshirëse/(humbja)	-	(347)	3,286	2,939
Gjendja më 31 dhjetor 2013	20,498	(106)	25,521	45,913
Neto fitimi për vitin	-	-	5,435	5,435
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse / (humbja)	-	106	-	106
Gjithsej të hyrat gjithpërfshirëse/(humbja)	-	106	5,435	5,541
Gjendja më 31 dhjetor 2014	20,498	-	30,956	51,454

Shënimet e bashkangjitura nga 10 deri 78 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB PRISHTINA SH.A.
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Per vitin e perfunduar me 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2014	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2013
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi gjatë vitit para tatimit		6,132	3,699
Zhvlerësimi	10	1,060	868
Amortizimi	11	214	203
Shpenzimet e provizioneve për humbjet nga kreditë		3,928	4,041
Shlyerja e pasurive afatgjata materiale		27	55
Provizionet dhe rezervat e tjera		624	191
Të hyrat nga interesi	18	(27,419)	(26,685)
Shpenzimet e interesit	19	9,603	12,664
		(5,831)	(4,964)
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet operative			
Rritja në rezervën e detyrueshme me BQK	4.1	(350)	(1,078)
Rritja në kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	(21,467)	(11,314)
Rritja në kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	(15,850)	(10,084)
Zvogëlimi/Rritja në pasuritë tjera financiare		2	(1)
Rritja/ Zvogëlimi në pasuritë tjera		(123)	57
Rritja në detyrimet ndaj bankave		156	657
Zvogëlimi/Rritja në detyrimet ndaj klientëve		(993)	40,323
Zvogëlim në detyrimet tjera financiare		(776)	(339)
Zvogëlim/Rritja në detyrimet e tjera		16	42
		(45,216)	13,299
Interesi i arkëtuar		27,402	26,477
Interesi i paguar		(11,831)	(12,352)
Tatimi i paguar në të ardhura	25	(614)	(578)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		(30,259)	26,846
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet investuese			
Blerjet e pasurive dhe pajisjeve	10	(2,491)	(1,398)
Blerjet e pasurive të paprekshme	11	(134)	(168)
Shitja/ (Blerje) e aktiveve financiare të disponueshme për shitje	8	4,805	4,299
Neto paraja e gatshme nga aktivitetet investuese		2,180	2,733
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet financiare			
Pagesa e huazimeve	16	(2,816)	(3,309)
Hyrja e parave nga aktivitetet financiare		(2,816)	(3,309)
Rritja e parave të gatshme		(30,895)	26,270
Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e tyre më 1 janar	4.1	126,146	99,876
Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj më 31 dhjetor	4.1	95,251	126,146

Shënimet e bashkangjitura nga 10 deri 78 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

1. INFORMATATA TË PËRGJITHSHME

NLB Prishtina Sh.a. është bankë komerciale (“Banka”) e regjistruar ne Regjistrinë e Kosovës nën Çertifikatën e Regjistrimit nr. 70053484 të datës 18 dhjetor 2007. Banka është krijuar nga bashkimi i dy bankave, Kasabank dhe Banka e re e Kosovës (gjatë vitit 2007 të dy bankat ishin nën kontroll të Nova Ljubljanska Banka d.d.), dhe ka fituar licencën për aktivitete bankare më 19 dhjetor 2007 nga Banka Qendrore e Kosovës (“BQK”).

Banka kontrollohet nga Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana me qendër në Slloveni (Banka amë), e cila posedon 81.21% të aksioneve sipas datës 31 dhjetor 2014 (31 dhjetor 2013: 81.21% të aksioneve). Aksionari i vetëm i Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana është Republika e Sllovenisë që posedon 100 % të aksioneve.

Qendra e Bankës gjendet në Rr. Kosta Novakovic P.N, Prishtinë, Kosovë. Banka vepron si bankë komerciale për të gjitha kategoritë e klientëve, përmes rrjetit të saj me 9 degë në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Gjilan, Besianë, Prizren, dhe 39 Nën-degë.

Banka më 31 dhjetor 2014 ka pasur 525 të punësuar (31 dhjetor 2013: 525).

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014 janë aprovuar nga Bordi Udheheqës më 30 janar 2015.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

2.1. Deklarata e përputhshmërisë

Banka përgatitë pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare të bankës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 janë përgatitur në përputhje me SNRF, siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe trupi paraprak. Krahas kësaj, janë zbatuar interpretimet e publikuara nga Komiteti për Interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (KISNRF).

Pasqyrat financiare SNRF të bankës përbëhen nga pasqyrat e gjendjes financiare, pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimit në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së parasë, politikat e rëndësishme kontabël dhe shënimet për pasqyrat financiare. Këto pasqyra financiare mbulojnë Bankën si njësi individuale e jo si prind.

2.2 Bazat e përgatitjes të pasygrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin e vazhdueshmërisë, në bazë të kostos historike, përveç ri-vlerësimit të pasurive në dispozicion për shitje si dhe pasuritë dhe detyrimet financiare vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Politikat kryesore kontabël janë të shpalosura si më poshtë.

2.2.1 Parimi i vazhdueshmërisë

Menaxhmenti i Bankës ka bërë një vlerësim të aftësisë së saj për të vazhduar biznesin dhe operacionet e saj dhe është i kënaqur që ka burime të mjaftueshme për të vazhduar biznesin e saj për të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, menaxhmenti nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar vijueshmërinë. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të jenë të përgatitura në bazë të parimit të vijueshmërisë.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.2 Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.2.2 Vlerësimet dhe supozimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe supozimeve që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, dhe daljen e aktiveve dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së raportimit. Edhe pse këto vlerësime janë bazuar në njohuritë më të mira të ngjarjeve dhe aktiviteteve aktuale nga menaxhmenti, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara. Vlerësimet Kontabël dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Vlerësimet e rëndësishme janë shpalosur në mënyrë më të detajuar në shënimin 2.21.

2.2.3 Të dhënat krahasuese

Përveç kur një standard apo një interpretim lejon apo e kërkon ndryshe, të gjitha shumat janë raportuar ose janë shpalosur me shumat krahasuese. Aty ku është e aplikueshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar për t'iu përshtatur ndryshimeve në paraqitjen në vitin aktual. Në vitin 2014 NLB Prishtina nuk ka rregulluar shifrat krahasuese.

2.3 Valuta funksionale

Në pajtim me SNK 21, valuta funksionale e Bankës është Euro pasi është valuta e mjedisit primar ekonomik ku banka operon dhe reflekton substancën ekonomike të ngjarjeve.

2.4 Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave për të gjitha instrumentet që sjellin interes në bazë akruale duke përdorur metodën efektive të kthimit.

2.5 Tarifat dhe komisionet

Të hyrat nga tarifat e komisionet dhe shpenzimet që rrjedhin nga dhënia, respektivisht përdorimi i shërbimeve bankare janë regjistruar në fitim dhe humbje siç kanë ndodhur, në momentin kur janë përfshirë shërbimet, respektivisht përdoruar ato.

Tarifat e menaxhimit të kredive që ka gjasa të tërhiqen deri në fund janë shtyrë (së bashku me kostot direkt të lidhura) dhe regjistrohen si një korigjim i normës efektive të interesit të kredisë.

Të ardhurat nga pagesat dhe komisionet dhe shpenzimet përfshijnë gjithashtu pagesat nga letër garancionet dhe letërkreditë e lëshuara nga Banka në favor të klientëve, detyrimet e pagesave që rrjedhin nga bankat vendore dhe ndërkombëtare, dhe shërbimet tjera të ofruara nga Banka.

2.6 Instrumentet Financiare

i. Njohja fillestare

Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare njihen fillimisht në datën e tregut, p.sh., data që Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshinë mënyrën e rregullt të tregut: blerjet apo shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë dhënie të aktivitetit brenda kuadrit kohor të përcaktuar në përgjithësi nga rregullorja ose marrëveshja në vendin e tregut.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet Financiare (vazhdim)

ii. Klasifikimi

Pasuritë financiare janë të klasifikuara në kategoritë si në vazhdim: pasuritë financiare në dispozicion për shitje, huatë dhe të arkëtueshmet. Klasifikimi i pasurive financiare përcaktohet në bazë të njohjes fillestare, varësisht nga karakteristika e instrumentit dhe qëllimit të menaxhmentit.

Huatë dhe të arkëtueshmet janë instrumente financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të determinuara të cilat nuk janë të kuotuar në tregjet aktive.

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje janë ato të cilat e kanë për qëllim të mbahen për një periudhë të papërcaktuar, të cilat mund të shiten sipas kërkesës së nevojës për likuidim apo ndonjë ndryshim në kamatat e interesit, ratat e këmbimit apo çmimit të ekuitetit.

iii. Matja

Pasuritë financiare maten fillimisht me vlerën e transaksionit plus kosto e transaksionit, nëse ka ndonjë. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit, nëse ka ndonjë. Pas njohjes fillestare këto më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Kosto e amortizuar llogaritet duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Primet dhe zbritjet, duke përfshirë kostot fillestare të transaksionit, përfshihen në vlerën kontabël të instrumentit përkatës dhe amortizuar në bazë të normës së interesit efektiv të instrumentit, kur është e aplikueshme.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një pasurie financiare dhe e ndarjes së të ardhurave nga interesi gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pranimet monetare të ardhshme (duke përfshirë të gjitha taksat mbi pikat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërëse të normës së interesit efektiv, kostot e transaksionit dhe primet ose zbritjet e tjera) gjatë jetës së pasurisë financiare, ose kur është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër.

iv. Instrumentet Specifike

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e saj janë artikujt të cilat mund të shndërrohen në para në një kohë të shkurtër (me më pak se tre muaj të maturimit origjinal) dhe të cilat janë objekt i një rreziku jo-domethënës të ndryshimeve në vlerë. Shumat që kanë të bëjnë me fondet që janë të një natyre të kufizuar janë të përjashtuara nga paraja dhe ekuivalentet. Ekuivalentet e parasë mbahen me koston e amortizuar.

Rezervat e detyrueshme të likuiditetit

Në përputhje me rregullat e BQK-së, Banka duhet të përmbushë kërkesën mesatare minimale të likuiditetit. Kërkesa e likuiditetit llogaritet në baza javore si 10% e bazës së depozitave, përcaktuar si mesatare e detyrimeve totale të depozitave për publikun jo-bankar në EUR dhe monedha të tjera, gjatë ditëve të punës të periudhës së mirëmbajtjes. Asetet me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e likuiditetit janë depozitat në euro me BQK-në dhe 50% e EUR, ekuivalentin e parave të gatshme, përcaktuar në valutë lehtësisht të konvertueshme. Depozitat me BQK-në nuk duhet të jenë më pak se 5% e bazës së depozitave në fuqi. Si aktivet likuide përkatëse nuk janë në dispozicion për të financuar ditën e Bankës për operacionet e përditshme, ata kanë qenë të përjashtuar nga paraja dhe ekuivalentet për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë.

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje

Në njohjen fillestare, në dispozicion për shitje, pasuritë financiare janë të regjistruara në vlerë të transaksioneve plus kostot e ndershme, nëse ka ndonjë. Më pas ato mbahen me vlerën e drejtë. Vlerat e drejta të raportuara janë ose çmime tregu të mbikëqyruar ose vlera e llogaritur me një teknikë vlerësimi të bazuar në tregun e tanishëm. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të disponueshme për shitje aktivet financiare njihen përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

pozicionin "rezervës së rivlerësimit nga instrumentet financiare të disponueshme për shitje", deri sa aktivi financiar çregjistrohet ose zhvlerësohet. Në këtë pikë, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse transferohet në pasqyrën e të ardhurave përmes riklasifikimit. Interesi i llogaritur duke përdorur metodën e normës efektive të interesit dhe fitimet e valutës së huaj dhe humbjeve të mjeteve monetare të klasifikuara si të vlefshme për shitje njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet klientëve klasifikohen si hua dhe llogari të arkëtueshme. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme maten me koston e amortizuar. Kostoja e amortizuar e një aktivi financiar ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus pagesa kryesore, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference mes shumëve fillestare dhe shumave të maturimit, dhe minus çdo zbritje (nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes) për dëmtim ose un-collectability. Huatë dhe paradhëniet raportohen neto nga ndihmat për kredi dëmtim të reflektuar shumëve të vlerësuar rikuperueshme.

v. Mos-njohja

Pasuritë financiare janë hequr kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuritë financiare kanë skaduar ose pasuritë financiare janë transferuar dhe transferimi kualifikohet për mosnjohje. Transaksioni është trajtuar si një transferim i një pasurie financiare, ku të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë janë transferuar. Kur Banka as nuk transferon, as ruan rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të pasurisë financiare, ajo do të përcaktojë nëse ka ruajtur kontrollin e pasurisë financiare. Një detyrim financiar çregjistrohet nga pasqyra e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur ajo shuhet. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë është shlyer ose anuluar ose skadon, dmth kur detyrimi i specifikuar në kontratë është shkarkuar, anuluar ose skadon.

vi. Rënia në vlerë e pasurive financiare

Bëhet një vlerësim në çdo datë të bilancit të gjendjes për të përcaktuar nëse ka një evidencë objektive që një pasuri financiare ose grup pasurish financiar mund të jetë zhvlerësuar. Nëse ekzistojnë prova të tilla, shumave që vlerësohet të merret dhe ndonjë humbje nga rënia e këtij aktivi përcaktohet, bazuar në vlerën neto aktuale të ardhshme të parashikuar të flukseve monetare, dhe njihet për diferencë midis shumëve të rikuperueshme dhe vlerës kontabël si vijon:

Kreditë dhe paradhëniet për klientët janë raportuar në bazë të kostos së amortizuar neto nga provizionet (lejimet) për të reflektuar shumëve të vlerësuar të rikuperueshme.

Një provision për rrezikun e kredisë për zhvlerësim është e themeluar nëse ka evidencë objektive që Banka nuk do të jetë në gjendje të mbledhë shumëve të duhura sipas kushteve fillestare kontraktuale. Shumave të provizionit është diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerësuar shumëve të rikuperueshme, e llogaritur si vlera aktuale e flukseve monetare të pritshme, duke përfshirë shumëve të rikuperueshme nga garancitë dhe kolateralin, të zbritur me normën fillestare të interesit efektiv të instrumentit.

Ndihmat janë bërë kundër vlerës kontabël të huave dhe paradhënieve që janë identifikuar si të zhvlerësuar bazuar në shqyrtimet e rregullta të bilanceve të papaguara për të reduktuar këto kredi dhe paradhëniet ndaj shumëve të rikuperueshme të tyre. Kompensimi për zhvlerësim të kredisë mbulon edhe humbjet kur ka evidencë objektive se humbjet e mundshme janë të pranishëm në komponentët e portofolit të kredisë në datën e bilancit. Këto janë vlerësuar në bazë të modeleve historike të humbjeve në çdo komponent dhe rating kreditit të caktuara për huamarrësit reflektojnë mjedisin e tanishëm ekonomik në të cilin veprojnë huamarrësit.

Banka së pari vlerëson nëse evidenca objektive e zhvlerësimit ekziston individualisht për aktivet financiare që janë individualisht të rëndësishme, dhe individualisht ose kolektivisht për aktive financiare që nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse Banka përcakton se nuk ka evidencë objektive zhvlerësimi për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm ose jo, ajo

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe vlerëson në mënyrë kolektive për zhvlerësimin e tyre.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

vi. Rënia në vlerë e pasurive financiare (vazhdim)

Pasuritë që janë vlerësuar individualisht për zhvlerësim dhe për të cilat një humbje nga zhvlerësimi është ose vazhdon të njihet, nuk përfshihen në vlerësimin kolektiv të zhvlerësimit.

Shuma e humbjes matet si diferencë midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të vlerësuara të ardhshme të parasë (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë që nuk kanë ndodhur), të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Vlera kontabël e pasurisë zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie lejimi dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje. Llogaritja e vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare të një pasurie financiare të kolateralizuar pasqyron flukset monetare që mund të rezultojnë në marrjen e posedimit të pasurisë minus kostot për përfitim dhe shitjen e kolateralit, nëse është apo jo i mundshëm.

Për qëllimet e vlerësimit kolektiv të zhvlerësimit, aktivitetet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë (dmth, në bazë të procesit të vlerësimit të Bankës që merr parasysh llojin e aktivitetit, industrinë, vendndodhjen gjeografike, llojin e kolateralit, statusin e kaluara-pasojë dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm). Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për grupe të tilla aktivesh, sepse janë tregues të aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat në përputhje me termat kontraktuale të aktiveve që janë të vlerësuara.

Të gjitha ekspozimet që kanë sasi të papaguar prej 100 mijë Euro ose më shumë për kategoritë A, B dhe C, ndërsa për kategoritë D dhe E ekspozimet më të mëdha se 10 mijë Euro vlerësohen individualisht ndërsa kreditë nën këtë nivel të pragut janë konsideruar të parëndësishme dhe të vlerësohen në bazë grupi për Kreditë që tregojnë shenja të ngjarjeve humbje.

Klasifikimi i kategorive është si në vijim:

Kategoria A- Standarde

Të gjitha kreditë apo shërbimet tjera të drejtpërdrejta kreditore dhe ekspozimet jashtë bilancore që bartin një rrezik normal bankar. Informacionet në dispozicion në lidhje me ekspozimet kreditore, performansën e llogarisë së klientit, dhe të dhënat financiare që të gjitha këto dëshmojnë se shlyerja e ekspozimit është mjaft e sigurtë dhe nuk ka ndonjë vështirësi (apo obligimi është i siguruar plotësisht me kolateral të përshtatshëm). Kredia është aktive, apo delikuenca nuk është vonuar më shumë se tri dhjetë – 30 ditë nga data e kthimit apo maturimit të kredisë. Mbitërheqjet duhet të jenë brenda limitit të caktuar, ose vetëm përkohësisht të tejkalojnë limitin prej 5% ose më pak se 30 ditë, si dhe rrjedha e parasë në llogarinë rrjedhëse është e mjaftueshme për të shlyer bilancin e mbitërheqjes brenda 30 ditëve nga data e skadimit të mbitërheqjes.

Kategoria B- Vrojtuese

Ky klasifikim duhet të përdoret për të identifikuar dhe monitoruar ekspozimet që përmbajnë dobësi apo dobësi potenciale të cilat në rastin e rishqyrtimit, nuk e rrezikojnë kthimin e kredisë apo nuk reflektojnë ndonjë potencial për ndonjë humbje, por të cilat, po qe se nuk adresohen apo nuk korigjohen mund të rezultojnë në keqësimin e kredisë në nën standard apo klasifikim më të ashpër. Në rast se ka mungesë të ndonjë dëshmie të dokumentuar që është e pafavorshme, apo këto kredi vonohen më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë atëherë bankat duhet t'i klasifikojnë këto kredi si "Kredi me vëmendje të posaçme", si dhe ato kredi që janë vazhdimisht në mbetje të borxhit në tejkallim të 5% të linjave të aprovuara për më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë. Kjo kategori e klasifikimit është përpiluar që t'ju mundësojë bankave që të identifikojnë dhe adresojnë marrëdhënie shumë të dobëta që në fazën e hershme.

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

vi. *Rënia në vlerë e pasurive financiare (vazhdim)*

Kategoria C - Nën-standarde

Ekspozimet të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, janë definuar qartë dobësitë e kredisë të cilat rrezikojnë pagesën e kredisë në një kurs normal. Një kredi nën standard është ajo kredi e cila në bazë të analizave të të dhënave financiare si dhe faktorëve të tjerë, nuk është e mbrojtur për momentin nga vlera e shëndoshë si dhe nga kapaciteti i pagesës së huamarrësit apo garantuesit ose vlera e kolateralit. Kërkohe mbështetje nga ana e garantuesve përgjegjës dhe të aftë për të kthyer kredinë gjë që do të përfshinte edhe negociata të vazhdueshme para se likuidimi i kredisë të kërkojë një klasifikim nën standard. Nevoja për të kërkuar mbështetjen e kolateralit si mjet për të shlyer obligimin duhet të jetë bazë për një klasifikim nën standard.

Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet nën standarde, të paktën nëse kriteriumet në vijim aplikohen:

- (a) Nëse depozitat / rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 60 ditëve që nga data e skadimit të kredisë .
- (b) Nëse klienti e ka tejkaluar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 60 ditë pa e paguar këtë tejkallim apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të paguar këstet e kredisë sipas kontratës (duke përfshirë edhe interesin) për më tepër se 60 ditë.
- (d) Nëse afati i kthimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 60 ditë për arsye të mospagimit.

Kategoria D- Të Dyshimta

Ekspozimet të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, përmbajnë të gjitha dobësitë të cilat janë të qenësishme në kreditë nën standarde, por të cilat theksojnë që ekzistojnë mundësitë e forta që pjesa e rëndësishme e shumës së këstit nuk do të paguhet. Ka mundësi të humbjes, mirëpo shuma e saktë nuk mund të definohet saktësisht në rastin e shqyrtimit apo kjo varet edhe nga shfaqja e ndonjë veprimi apo rasti në të ardhmen. Ndonëse mundësia e humbjes është jashtëzakonisht e lartë, për shkak të faktorëve të rëndësishëm dhe të pazgjidhur specifik, por të cilët mund të funksionojnë për të mirën dhe përforcimin e kredisë, klasifikimi i saj si humbje e përafërt mund të shtyhet deri sa të përcaktohet një status më i saktë. Shembuj të faktorëve të tillë përfshihen por nuk janë të limituar në bashkimin, përvetësimin, ristrukturimin e kapitalit, si dhe furnizimin me kolaterale të reja apo plane të reja të rifinancimit. Garantuesve që nuk bashkëpunojnë apo atyre që janë në një gjendje të dobët financiare nuk duhet të konsiderohen si të aftë për të mbështetur kredinë.

Mbështetje në çfarëdo kolaterali të disponueshëm që nuk do të ishte i mjaftueshëm për të mbuluar shumën gjithashtu mund të arsyetojnë klasifikimin e dyshimtë.

Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet si i dyshimtë, të paktën nëse kriteriumet në vijim aplikohen:

- (a) Nëse depozitat / rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 90 ditëve që nga data e skadimit
- (b) Nëse klienti e ka tejkaluar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 90 ditë pa e paguar këtë tejkallim apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

vi. *Rënia në vlerë e pasurive financiare (vazhdim)*

- (c) Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontraktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkalon 90 ditë.
- (d) Nëse ka mungesë në gjendjen financiare të klientit që ka shkaktuar kapital negativ.
- (e) Nëse afati i kthimit/përfundimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 90 ditë për arsye të mospagimit.

Kategoria E- Kreditë e këqija (humbje)

Janë ato ekspozime të cilat janë të bazuara mbi një analizë të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, kanë vlerë të vogël ose do të kërkojnë një periudhë shtesë për të realizuar ndonjë vlerë dhe nuk janë më të arsyeshme që të mbahen në librat aktive të bankës.

Një ekspozim mund të konsiderohet si i ekspozim i keq (humbje) nëse ndonjë nga kriteret në vijim aplikohet:

- (a) Nëse depozitat/rjedha e parasë në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e mbitërheqjes të papaguar brenda 180 ditëve nga data e skadimit të mbi tërheqjes.
- (b) Nëse klienti e ka tejkaluar limitin e autorizuar të kredisë mbi 5% apo më shumë për mbi 180 ditë pa e paguar këtë mbitërheqje apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontraktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkalon 180 ditë.
- (d) Nëse afati i kthimit/data e skadimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 180 ditë për arsye të mospagimit.

Zhvlerësimet dhe rezervat për pjesën e mbetur të portfolios së ndërmarrjeve, pronarëve të vetëm dhe klientëve të vegjël (kërkesat nga klientët që nuk janë individualisht të rëndësishëm) dhe për kërkesat nga klientët individualisht të rëndësishëm (përveç bankave) për të cilët nuk ka asnjë provë të zhvlerësimit, llogariten në baza grupore (qasja e portfolios). Kreditë në grup janë të ndara më tej në kategoritë, ndërmarrje dhe pronarë të vetëm, grupe të klientëve të vegjël në bilancin e gjendjes. Të gjitha të tri grupet më tej ndahen në pesë nën kategoritë A, B, C, D, dhe E.

Kur një kredi konsiderohet e pa-arkëtueshme, ajo shlyhet me rezervat përkatëse për zhvlerësimin kreditor. Kredi të tilla shlyhen pasi të gjitha procedurat e nevojshme të kenë përfunduar dhe shuma e humbjes të jetë përcaktuar. Rikuperimet pasuese të shumave të zbritura më parë janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave.

Nëse shuma e provizionit për kreditë e provizionuara më pas zvogëlohet për shkak të ndonje ngjarjeje që ndodh pas shlyerjes, lirimi i provizionit kreditohet në pasqyrën e fitimit dhe humbjes.

Pasuritë financiare të mbajtura për shitje - Banka vlerëson në çdo datë të bilancit të gjendjes nëse ka evidencë objektive që pasuritë financiare në dispozicion për shitje janë zhvlerësuar. Në rast të Investimeve të kapitalit të klasifikuara si të disponueshme për shitje, rënia e konsiderueshme ose e zgjatur në vlerën e drejtë të pasurisë nën koston e tij konsiderohet si një evidencë objektive e zhvlerësimit. Nëse ndonjë evidencë e tillë ekziston, humbja kumulative largohet nga të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse dhe regjistrohet në fitim dhe humbje. Humbjet nga zhvlerësimet të regjistruara në fitim dhe humbje të Instrumentave të kapitalit nuk kthehen nëpërmjet fitimit dhe humbjes; rritja pasuese e vlerës së drejtë pas zhvlerësimit regjistrohen në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

vi. Rënia në vlerë e pasurive financiare (vazhdim)

Nëse, në një periudhë pasuese, vlera e drejtë e një instrumenti borxhi të klasifikuar si në dispozicion për shitje, rritet dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur në fitim dhe humbje, humbja nga zhvlerësimi anulohet nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

Faktorët e mëposhtëm janë marrë parasysh në përcaktimin e humbjeve nga zhvlerësimi mbi instrumentet e borxhit:

- Mospagesa apo delikuenca në pagimin e interesit ose principalit;
- Vështirësitë e likuiditetit të emetuesit;
- Shkelja e besëlidhjeve të kontratës ose kushtet;
- Falimentimi i emetuesit;
- Përkeqësimi i kushteve ekonomike dhe të tregut; dhe
- Përkeqësimi në klasifikimin e kredive të emetuesit nën nivel të pranueshëm.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë të matura si diferenca midis vlerës kontabël neto të aktivitetit financiar dhe vlerës së tij të drejtë aktuale. Vlera aktuale e drejtë e instrumentit është çmimi i saj i tregut ose flukset e ardhshme të mjeteve monetare zbritur, kur çmimi i tregut nuk është i arritshëm.

2.7 Valutat e huaja

Transaksionet në valutë të huaj përpos në Euro këmbehen në valutë funksionale me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e transaksionit. Fitimet në valutë të huaj dhe humbjet që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve të tilla dhe nga këmbimi i aseteve dhe detyrimet monetare në valutë të huaj regjistrohen si fitim dhe humbje (si fitimet dhe humbjet të këmbimit valutor).

Zërat jo-monetar, që maten në aspektin e kostos historike në një valutë të huaj nuk ri - konvertohen.

2.8 Prona dhe pajisjet

Pronat, ndërtesat dhe pajisjet janë paraqitur me kosto sipas SNK 16 Ato paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar, nëse kërkohet. Çdo vit, Banka vlerëson nëse ka indikacione që asetet mund të jenë të dëmtuara. Nëse ndonjë indikacion i tillë ekziston, shumat e rikthyeshme duhet të vlerësohen. Shuma që vlerësohet e rikthyeshme është lartësia e vlerës së drejtë të një aseti minus kosto e shitjes dhe vlera e saj-në-përdorim. Kur vlera kontabël e një pasurie është më e madhe se shumta e vlerësuar për arkëtim, ajo shlyhet deri në shumën e arkëtueshme dhe ndryshimi i ngarkohet fitimit ose humbjes.

Fitimet dhe humbjet me rastin e shitjes/shlyerjes së pronës, ndërtesave dhe pajisjeve janë të përcaktuara duke iu referuar vlerës kontabël dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën. Riparimet dhe mirëmbajtja i ngarkohen fitimit ose humbjes kur shpenzimi ka ndodhur.

Zhvlerësimi ngarkohet duke përdorur metodën lineare, mbi kohëzgjatjen e vlerësuar të çdo pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve. Për amortizimin e mëtejshëm ngarkohet pas muajit të blerjes, ndërsa për shitjet deri në muajin e shitjes zhvlerësimet nuk fillojnë deri sa asetet të jenë në dispozicion për përdorim.

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.8 Prona dhe pajisjet (vazhdim)

Normat vjetore të amortizimit të përdorura për çdo kategori të pronës dhe pajisjeve janë si në vijim:

Kategoria e asetëve	Normat e përdorura të zhvlerësimit
Ndërtesat	3%
Renovimi i objekteve të mara me qira	Afati më i ulët i qirasë ose 20%
Mobile, instalime dhe pajisje	20%
Kompjuterë dhe pajisje shtesë	20%
Automjete motorike	20%

Menaxhimi shqyrtuar jetët e dobishme dhe vlera e mbetur e ndërtesave më 1 janar 2013. Pas këtij shqyrtimi, jeta e dobishme e mbetur nga ndërtesat që përdoren nga Banka për operacionet e saj është vlerësuar 33 vjet në vend të 20 viteve të përdorura më parë.

Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme kontabilizohen duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël. Vlera neto kontabël e ndërtesave në datën e vlerësim/ndryshimit paraqet shumën e amortizueshme të re.

Më 1 janar 2013, kostoja historike e ndërtesave jeta e dobishme e të cilit u rishikua ishte 3,251 mijë Euro dhe amortizimi i akumuluar ishte 1,136 mijë Euro. Rrjedhimisht, shumta e amortizueshme duke filluar nga 1 janar 2013 1,136 mijë Euro më pak se kostoja historike e ndërtesave e shpalosur në Shënimin 10 të pasqyrave financiare.

2.9 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme të marra nga Banka paraqiten me kosto më të ulët të akumuluar të amortizimit dhe humbjeve, kur kërkohet. Zhvlerësimi është dhënë në bazë lineare në një normë vjetore prej 20%. Shpenzimet e mëtejme në pasuritë e kapitalizuara të paprekshme kapitalizohen vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me pasuritë e veçanta me të cilat ka lidhje. Të gjitha shpenzimet e tjera regjistrohen siç janë shkaktuar. Amortizimi nuk fillon deri sa asetet të jenë në dispozicion për përdorim.

2.10 Pasuritë financiare në dispozicion për shitje

Pasuritë jo-xhiruese janë klasifikuar si të mbajtura për shitje në qoftë se shumta e tyre mbajtëse do të mbulohet kryesisht përmes një transaksioni shitjeje në vend se përmes përdorimit të vazhdueshëm. Ky kusht konsiderohet i përmbushur vetëm kur shitja është shumë e mundshme dhe pasuria është në dispozicion për shitje të menjëhershme në gjendjen e saj aktuale. Menaxhmenti duhet të jetë këmbëngulës në shitje, e cila mund të pritet të kualifikohet për njohje si një shitje e përfunduar mbrenda një viti nga data e klasifikimit.

Pasuritë jo-xhiruese të klasifikuara si të mbajtura për shitje maten me shumë më të ulët se ajo e mëparshme dhe vlera e tregut duke zbritur koston për shpenzime të shitjes.

2.11 Pasuritë e konfiskuara

Pasuritë e konfiskuara përfaqësojnë asetet financiare dhe jo-financiare të konfiskuara nga banka për shlyerjen e kredive të vonuara. Asetet regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë kur konfiskohen dhe përfshihen në ndërtesat dhe pajisjet, asetet tjera financiare ose inventaret brenda asetëve tjera në varësi të natyrës së tyre dhe qëllimit të Bankës në lidhje me rikthimin e këtyre asetëve, dhe më pas rivlerësohen dhe llogariten për në përputhje me politikat kontabël për këto kategori të asetëve.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.12 Zhvlerësimi i pasurive jo-financiare

Një zhvlerësim i humbjes regjistrohet kur vlera kontabël e një aseti e tejkalon shumën e arkëtueshme. Shuma e arkëtueshme e asetit është më e lartë nga çmimi neto i shitjes dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorimin e një aseti është vlera aktuale e qarkullimit të parashikuar të parasë në të ardhmen që pritet nga përdorimi i vazhdueshëm i një aseti dhe nga shitja e tij.

2.13 Detyrimet ndaj bankave

Detyrimet ndaj bankave janë të regjistruara kur paratë ose asetet tjera janë dhënë avanc në bankë nga bankat palëve tjera. Detyrimet jo-derivative realizohen me kosto të amortizuara.

2.14 Detyrimet ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve janë detyrimet jo-derivative ndaj individëve, shtetit, apo klientëve korporata dhe mbahen me kosto të amortizuara.

2.15 Huamarrjet

Huamarrjet regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut, duke marrë parasysh vlerën reale/tregut dhe duke zbritur shpenzimet e transaksionit. Huamarrjet janë paraqitur më pas me kosto të amortizuara. Çdo interes ose taksë që lidhet me fondet e huazuara është paraqitur në fitimin ose humbjen për periudhën.

Kostot e huamarrjes që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin, ndërtimin apo prodhimin e një aktivi të kualifikuar janë të pranuar si pjesë e kostos së këtij aseti. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes pranohen si shpenzim në periudhën në të cilën ai ndodh.

2.16 Tatimi në fitim

Tatimi në fitim për vitin aktual llogaritet në bazë të rregullave të tatimit mbi të ardhurat në fuqi në Kosovë, duke përdorur normat në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Në fuqi nga data 1 janar 2010, norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është vendosur në 10 %, në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës aktualisht Në fuqi, ligji nr. 03/L-162. "Tatimi mbi të ardhurat e Korporatës". Paga e tatimit mbi të ardhurat në fitim ose humbje për vitin përmban tatimin aktual, të periudhës dhe ndryshimet në tatimet e shtyra. Tatimi aktual i periudhës llogaritet në bazë të fitimit të pritshëm të tatueshëm për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi siç është raportuar në bilancin e suksesit sepse përjashton zëra të të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose zbritshme në vitet e tjera dhe më tej përjashton zëra që nuk janë të tatueshme ose zbritshme. Tatimet tjera përpos tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative. Tatimi në të ardhurat e shtyra llogaritet duke përdorur metodën e bilancit të detyrimeve për të gjitha diferencat e përkohshme që rrjedhin në mes bazës tatimore të aseteve dhe detyrimeve dhe shuma e tyre mbajtëse për qëllime të raportimit financiar. Tatimet në të ardhurat e shtyra janë të përfshira deri në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme. Tatimet në të ardhurat e shtyra ulen deri në atë masë që nuk është më e mundshme që të realizohet përfitimi në lidhje me tatimin. Tatimi në pasuritë e shtyra dhe detyrimet maten me norma tatimore që pritet të zbatohet për periudhën kur pasuria realizohet ose detyrimi është i vendosur në bazë të normave të taksave që kanë qenë në fuqi ose në nën-fuqi në datën e bilancit. Tatimi në pasuritë e shtyra dhe detyrimet kompensohet kur ekziston e drejta e ekzekutueshme ligjrisht për të vendosur tatimin aktual të pasurisë kundër detyrimeve tatimore dhe kur ato kanë të bëjnë me të ardhurat e mbledhura nga autoriteti i njëjtë tatimor.

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.17 Angazhimet e zërave jashtë-bilancor dhe ngjarjet e paparashikuara

Në kursin e zakonshëm të afarizmit të saj, Banka ka hyrë në zotime jashtë-bilancore si garancione, zotime për zgjatje të kredive dhe letër kredive dhe transaksioneve me instrumente financiare. Provizionit për humbjet në zotime dhe detyrime kontingente/te mundshme mbahet në një nivel adekuat për të absorbuar humbjet e mundshme në të ardhmen. Menaxhmenti përcakton përshtatshmërinë e provizionit bazuar mbi rishikimin e zërave individual, historikut të humbjeve të fundit, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të riskut të kategorive të ndryshme të transaksioneve dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm.

Kontratat e garancioneve financiare janë kontrata që kërkojnë që emetuesi të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për humbjen që ka pësuar për shkak se një debitor specifik nuk arrin të bëjë pagesat në kohën e duhur, në përputhje me kushtet e një instrumenti debitor. Garancionet e tilla financiare u janë dhënë bankave, institucioneve financiare dhe organeve tjera në emër të klientëve për të siguruar kredi, mbitërheqje dhe produkte të tjera bankare.

Garancionet financiare në datën e lëshimit regjistrohen me vlerën e drejtë e cila është e barabartë me shumën e pagesës së pranuar. Pagesa amortizohet në fitimin dhe humbjen gjatë periudhës së kontratës duke përdorur metodën lineare. Detyrimeve të bankës sipas garancioneve më pas maten me: matjen fillestare, amortizimi i zbritur i llogaritur për të regjistruar të ardhurat gjatë periudhës së garancionit ose vlerësimit më të mirë të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimin.

Garancionet për përfundim/kompletim - janë kontrata që kërkojnë nga emetuesi të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për një humbje të pësuar për shkak se një debitor specifik nuk arrin të përfundojë punën me kohë, në përputhje me kushtet e kontratës.

Garancionet në datën e emetimit regjistrohen me vlerën e drejtë e cila është e barabartë me shumën e pagesës së pranuar. Pagesa amortizohet në fitimin dhe humbjen gjatë periudhës së kontratës duke përdorur metodën lineare. Detyrimet e bankës sipas garancioneve më pas maten me: Matjen fillestare, amortizimi i zbritur i llogaritur për të regjistruar të ardhurat gjatë periudhës së garancionit; Vlerësimin më të mirë të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimin.

2.18 Provizionet

Rezervimet regjistrohen kur Banka ka një obligim të tanishëm ligjor ose konstruktiv, si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një qarkullim i burimeve që përmban përfitim ekonomike do të nevojitet që të zgjidhin detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimeve. Rezervimet maten me vlerësimin më të mirë të menaxhmentit për shpenzimet e nevojshme për të zgjidhur detyrimin në datën e pasqyrës së pozicionit financiar dhe zbriten në vlerën aktuale ku efekti është material.

2.19 Përfitimet e të punësuarve

Banka paguan kontribute për planin pensional të administruar publikisht (TKPK) në baza të obligueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi që kontributet të paguhen. Kontributet regjistrohen si shpenzime për përfitim të punësuarve atëherë kur ato duhet të paguhen.

2.20 Qiratë operative

Pagesat e bëra për qiratë operative i ngarkohen shpenzimeve mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Kur një qira operative ndërprehet para të mbarojë periudha e qirasë, çdo pagesë kërkohet ti bëhet qiradhënësit si penalti/dënim regjistrohet si shpenzim në periudhën në të cilën ka ndodhur ndërprerja.

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.21 Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Në zbatimin e politikave të Bankës për kontabilitet, që përshkruhen në shënimin 3, menaxhmenti duhet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumat e bartura të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë të qarta nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të jenë të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në baza të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël regjistrohet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar. Nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme, nëse rishikimi ndikon në të dyja periudhat aktuale dhe të ardhshme.

a) *Zhvlerësimi i kredive të klientëve*

Në përcaktimin, nëse kreditë e klientëve janë zhvlerësuar në baza individuale, kërkohet vlerësimi i vlerës aktuale të flukseve monetare të pritshme nga huatë për klientët duke përfshirë shumat e rikuperueshme nga garancitë dhe kolateralin. Menaxhmenti i bankës është duke përdorur gjykimin në vlerësimin rrjedhën e pritshme të parasë nga portofolio e kredisë. Supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e meritat e kredisë së klientit është i bazuar në pozicionet financiare, profitit, pjesë të tregut, si dhe vlerën e kolateralit, si dy burimet kryesore të flukseve monetare të pritshme. Në mënyrë të ngjashme rrethanat mbizotëruese në rajonin e klientit janë marrë në konsideratë, të tilla si efikasitetin e gjykatës.

Huatë dhe paradhëniet që janë vlerësuar individualisht dhe të gjetura nuk janë të zhvlerësuar janë vlerësuar gjithashtu së bashku me të gjitha kreditë individuale të parëndësishme dhe përparimet në grupe aktivesh me karakteristika të ngjashme të rrezikut. Vlerësimi kolektiv merr parasysh të dhënat historike dhe përdor probabilitetin e parazgjedhur për të siguruar se nivelet e duhura të dispozitave janë të mirëmbajtura.

b) *Norma efektive e interesit*

Siç është shpjeguar në Shënim 2.4 të ardhurat dhe shpenzimet e interesit janë njohur në fitim dhe humbje për të gjitha instrumentet që bartin interes në baza aktuale duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat e vlerësuar në ardhshme monetare ose arkëtimet me anë të jetës së pritshme të instrumentit financiar. Norma efektive e interesit ndryshon nga norma e kontraktuar, si rezultat i taksave dhe komisionit që Banka mund të ngarkuar, megjithatë, Banka nuk ka instrumente financiare ku pagesa shtesë dhe komisionet përfaqësojnë flukse të konsiderueshme të holla në krahasim me normën kontraktuale. Flukset e mjeteve monetare më të rëndësishme lindin nga tarifat që aplikohen në lëshimin e kredisë kreditimit. Për shkak të sistemit të informacionit kufizon, Banka nuk përdor normën e interesit efektiv të njohë të ardhurat e përgjithshme të interesit nga kreditë, por shtyn tarifat e kreditimit veçmas mbi jetën e çdo kredie duke përdorur një metodë që përafrojnë normën e interesit efektiv dhe menaxhimin e vlerëson se nuk ka dallime materiale që do të lindin.

c) *Tatimi*

Shpenzimi aktual tatimore

Banka i nënshtrohet ligjeve tatimore në Republikën e Kosovës. Menaxhmenti përdor vlerësimin e saj më të mirë dhe gjykimin në përputhje të plotë me ligjet përkatëse tatimore. Për shkak të përdorimit të gjykimin në përputhje me kërkesat e caktuara të ligjeve tatimore dhe në varësi të vlerësimit të autoriteteve tatimore, detyrimet tatimore mund të ndryshojnë në krahasim me atë të raportuar në pasqyrat financiare, megjithatë menaxhmenti është i bindur se nuk mund të ketë dallime materiale.

Tatimi i shtyrë i pasurive

Tatimi i shtyrë i pasurive njihet në lidhje me diferenat e përkohshme deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit humbjet mund të shfrytëzohen. Gjykimi është i nevojshëm për të përcaktuar shumën e aktiveve të shtyra tatimore që mund të njihen, të bazuar mbi kohën, mundshëm dhe nivelin e fitimit të tatueshëm të ardhshëm, së bashku me strategjitë e ardhshme të taksave-planifikimit. Humbjet tatimore mund të përdoren për një periudhë prej 7 vjetësh në Kosovë.

d) Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Ku vlerat e drejta të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të rrjedhin nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një shumëllojshmëri të teknikave të vlerësimit që përfshijnë përdorimin e modeleve matematikore. Pasuritë financiare në dispozicion për shitje të bankës janë vetëm pasuritë e matura me vlerën e drejtë dhe ata nuk janë të rëndësishme për aktivet financiare të përgjithshëm. Për qëllim të publikimit të vlerës së drejtë të pasurive dhe detyrimeve të tjera financiare, modelet e vlerësimit janë përdorur e bazuar në të dhëna të vëzhgueshme të tregut ku është e mundur, por nëse kjo nuk është në dispozicion, gjykimi është e nevojshme për të krijuar vlerat e drejta. Deklarimi i vlerës së drejtë të instrumenteve financiare dhe metodat e përdorura janë përshkruar më hollësisht në Shënim 30 (n).

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET

3.1 Standardet dhe amendamentet efektive në periudhën e tanishme

Standardet e reja dhe interpretimet e tyre si më poshtë kanë hyrë në fuqi për bankën me 1 janar 2014:

- **SNK 32 Instrumentet financiare: Paraqitja (e Amenduar) - Kompensimi i pasurive financiare dhe detyrimeve financiare**
Këto ndryshime kanë qartësuar kuptimin e "aktualisht ka një të drejtë ligjërish të zbatueshme për të". Ndryshimet gjithashtu qartësojnë zbatimin e SNK 32 kritereve të kompensimit në sistemet e shlyerjes (të tilla si sistemet e kliringut qendrorë) të cilat zbatohen mekanizma të shlyerjes bruto që nuk janë të njëkohshme. Aplikimi i këtyre ndryshimeve nuk ka pasur ndonjë efekt në politikën e Bankës.
- **SNK 39 Instrumentet financiare (e amenduar): Njohja dhe Matja -novacion i derivateve dhe Vazhdimi i Kontabilizimi i mbrojtjes (Hedge)**
Banka nuk ka instrumente derivate dhe ky ndryshim nuk ndikon tek Banka.
- **SNK 36 Zhvlerësimi i Aktiveve (Amenduar) - rikuperueshme Shuma Dhënia e informacioneve shpjeguese për Aseteve jo-financiare**
Këto ndryshime kanë hequr pasojat paqëllimshme të SNRF 13 mbi dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara sipas SNK 36. Përveç kësaj, këto ndryshime kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese të shumave të rikuperueshme për asetet ose CGUs për të cilat humbje nga rënia ka qenë e njohur ose të anuluar gjatë periudhës. Banka nuk ka ndonjë të njohur ndonjë dëmtim të aseteve jo-financiare dhe si rezultat, ky ndryshim nuk ndikon Bankën.
- **Interpretimi IFRIC 21: Masë për marrje pasurie**
Banka nuk ka ndonjë masë për marrje të pasurisë të imponuar dhe rrjedhimisht ky interpretim i ri nuk ka pasur ndonjë ndikim në Bankën.

3.2 Deklarimet e reja të Kontabilitetit

Disa standarde të reja dhe interpretimet janë lëshuar që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014 ose më vonë, dhe të cilat Banka nuk i ka miratuar në fillim. Standardet dhe amendamentet që nuk janë të aplikueshme në të gjitha të Bankës nuk janë diskutuar.

- **SNK 16 Aktivët Afatgjatë & Pajisje dhe SNK 38 Aktivët e patrupëzuara (Amendamenti): Qartësimi i Metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit**
Amendimi hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016. Ky amendim sqaron parimin në SNK 16 Aktivët Afatgjatë Materiale dhe SNK 38 Aktivët jo-materiale të ardhurave reflektojnë një model të përfitimeve ekonomike që gjenerohen nga operimi i një biznesi (në të cilën pasuria është pjesë) në vend se të përfitimeve ekonomike që janë konsumuar përmes përdorimit të aktivitetit. Si rezultat, raporti i të ardhurave i krijuar për të ardhurat e përgjithshme që pritet të gjenerohet nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar pronën, impiantet dhe pajisjet dhe mund të përdoret vetëm në raste shumë të rralla për të amortizuar aktive jo-materiale. Bankat aktualisht nuk e përdorin për qëllime të zhvlerësimit raportin e specifikuar e të ardhurave dhe Menaxhimi ka vlerësuar se ky sqarim nuk do të ndikojë në Bankën kur standardi bëhet efektiv.
- **SNK 19 Përfitimet e punonjësve (i amenduar): Kontributet e punonjësve**
Amendamenti është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014. Amendamenti vlen për kontributet nga punonjësit ose palët e treta të skemave të përfitimeve të përcaktuara. Aktualisht, Banka nuk ofron ndonjë plan për të punësuarit dhe ky ndryshim nuk do të ndikojë në Bankën.
- **SNRF 9 Instrumentat Financiare - Klasifikimi dhe matja**
Standardi zbatohet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018 me miratimin e hershëm të lejuar. Faza finale e SNRF 9 pasqyron të gjitha fazat e projektit të instrumenteve financiare dhe zëvendëson SNK 39 Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9. Standardi prezanton kërkesat e reja për klasifikimin dhe matjen, dëmtimin, dhe kontabilitetin mbrojtës. Menaxhmenti është ende në proces për të vlerësuar ndikimin e këtij ndryshimi dhe nëse ajo do të adoptojë standardet më herët.

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (vazhdim)

3.2 Deklarimet e reja të Kontabilitetit (vazhdim)

- **SNRF 11 marrëveshjet e përbashkëta (Amendament): Kontabiliteti për Blerjet e Interesave në Operacioneve të Përbashkëta:**
Banka nuk ka ndonjë marrëveshje të përbashkët.
 - **SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët**
Standardi është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2017. SNRF 15 përcakton një model pesë-hapësh që do të aplikojnë për të ardhurat e fituara nga një kontratë me një klient (me përjashtime të kufizuara), pavarësisht nga lloji i transaksionit të ardhurave ose industrisë. Kërkesat e Standardit do të zbatohen edhe për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve në shitjen e disa aktiveve jo-financiare që nuk janë një prodhim i aktiviteteve të zakonshme të njësisë ekonomike (p.sh., shitja e pronës, impianteve dhe pajisjeve ose atyre te paprekshme). Dhënia e informacioneve shpjeguese të gjera do të jetë e nevojshme, duke përfshirë edhe ndarjen e të ardhurave totale; informacion në lidhje me detyrimet e performancës; ndryshimet në bilancet e aseteve të kontratës dhe të llogarive detyrim midis periudhave dhe gjykimeve kryesore dhe vlerësimeve. Menaxhimi është ende në procesin e vlerësimit të ndikimit standarde do të ketë, por duke qenë një institucion financiar, nuk pritet që të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm për Bankën.
 - **SNK 27 Pasqyrat Financiare Individuale (i amenduar)**
Amendamenti hyn në fuqi nga 1 janar 2016. Ajo do të lejojë njësitë ekonomike për të përdorur metodën e kapitalit neto për të kontabilizuar investimet në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe bashkëpunëtorë në pasqyrat financiare individuale të tyre dhe do të ndihmojë në disa juridiksione të shkojë në SNRF për pasqyrat financiare të veçanta, duke reduktuar kostot e pajtueshmërisë pa zvogëluar informacionin në dispozicion për investitorët. Banka aktualisht nuk ka investime në subjektet e tjera dhe amendamentet nuk do të ndikojnë Bankën.
 - **Ndryshimi në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në Pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta: Shitje apo Kontributi i Aktiveve në mes të një Investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrje të përbashkët**
Amendamentet do të jenë efektive nga periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016. Banka aktualisht nuk ka investime në subjekte të tjera, ajo nuk përgatit pasqyra financiare të konsoliduara dhe amendamentet nuk do të ndikojnë Bankën.
 - **BSNK ka nxjerrë Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF-ve 2010 - 2012**, që është një koleksion i amendamenteve të SNRF-ve. Amendamentet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014.
 - **SNRF 13 Matja me vlerë të drejtë:** Ky përmirësim në Bazat e Përfundim i SNRF 13 qartëson se lëshimin SNRF 13 dhe SNRF ndryshimin 9 dhe SNK 39 nuk e ka hequr mundësinë për të matur të arkëtueshmet afatshkurtër dhe llogaritë të pagueshme pa normë interesi të shpallura në faturën e tyre pa zbritje, nëse efekti i zbritjes është jomaterial.
 - **SNK 16 Prona, Ndërtesa dhe Pajisjet:** ndryshimi sqaron se kur një objekt i pronës, impianteve dhe pajisjeve të rivlerësohet, vlera kontabël bruto është përshtatur në një mënyrë që është në përputhje me rivlerësimin e vlerës kontabël neto. Banka nuk përdor modelin e rivlerësimit të SNK 16.
 - **SNK 24 Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura:** Amendamenti sqaron se një njësi ekonomike ofrimin e shërbimeve kryesore të personelit të menaxhimit për njësinë ekonomike raportuese ose të prindit të njësisë raportuese është palë e lidhur e njësisë ekonomike raportuese. Sqarim mund të përfshijnë entitete të tilla në palët e lidhura të Bankës.
 - **SNK 38 Aktivitet e grupuara:** Amendamenti sqaron se kur një aktiv jo-material rivlerësohet vlera kontabël bruto është përshtatur në një mënyrë që është në përputhje me rivlerësimin e vlerës kontabël neto. Banka aktualisht nuk e përdor modelin e rivlerësimit për pasuritë e grupuara.
- Standardet në vijim që kanë ndryshuar, por nuk janë të zbatueshme në Bankën:
- **SNRF 2 Pagesa të bazuara në aksione**
 - **IFRS 3 Kombinimet e biznesit**
 - **IFRS 8 Segmentet e operimit**

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

**3. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE
INTERPRETIMET (vazhdim)**

3.2 Deklarimet e reja të Kontabilitetit (vazhdim)

- **BSNK ka nxjerrë Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF-ve 2011 - 2013**, që është një koleksion i amendamenteve të SNRF-ve. Amendamentet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2014.
 - **SNRF 13 Matja me vlerë të drejtë:** Ky përmirësim sqaron se fushëveprimi i përjashtimit të portofolit të përcaktuar në paragrafin 52 të SNRF 13 përfshinë të gjitha kontratat llogaritjet për brenda objektit të SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja ose SNRF 9 Instrumentat Financiarë, pavarësisht nëse ata plotësojnë përkufizimin e aktiveve financiare ose pasiveve financiare siç përcaktohet në SNK 32 Instrumentat Financiar: Paraqitja. Aktualisht, Banka nuk ka ndonjë portofol të aktiveve dhe detyrimeve që menaxhohet në bazë të ekspozimit neto, siç përkufizohet në SNRF 13, kështu që ky sqarim nuk ndikon Bankën.
 - **SNK 40 Investimet në Pronë:** Ky përmirësim sqaron në përcaktimin nëse një transaksion specifik plotëson përkufizimin e një kombinimi biznesi, siç përcaktohet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit dhe afatgjatë material i investuar siç përkufizohet në SNK 40 Pronës Investime kërkon aplikim të veçantë të të dy standardeve në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri. Banka nuk është angazhuar në ndonjë kombinim biznesi që mund të plotësojnë përkufizimin e pronës e investimeve.
 - **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit:** Ky përmirësim qartëson se SNRF 3 përjashton nga objekti i tij kontabilitetin për formimin e një marrëveshjeje të përbashkët në pasqyrat financiare të marrëveshjes së përbashkët vetë. Banka nuk ka ndonjë kombinim të vazhdueshëm ose të planifikuar të biznesit.
- **BSNK ka nxjerrë Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF-ve 2012 - 2014**, që është një koleksion i amendamenteve të SNRF-ve. Amendamentet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016.
 - **SNRF 5 Pasuritë afatgjata që mbahen për t'u shitur dhe operacionet jo të vijueshme:** Amendamenti sqaron se në ndryshim nga një nga metodat për hedhjen në tjetrën (përmes shitjes apo përmes shpërndarjes për pronarët) nuk duhet të konsiderohet të jetë një plan i ri i disponueshem, por ajo është një vazhdim i planit origjinal. Prandaj nuk ka ndërprerje e zbatimit të kërkesave të SNRF 5. Amendamenti gjithashtu sqaron se ndryshimi në metodën e deponimit nuk ndryshon datën e klasifikimit.
 - **SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese:** Amendamenti sqaron se një kontratë shërbimi që përfshin një tarifë mund të përbëjë përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar. Gjithashtu, amendamenti sqaron se SNRF 7 Dhënia e informacioneve shpjeguese që lidhet me kompensimin e pasurive dhe detyrimeve financiare nuk janë të nevojshme në raportin financiar të ndërmjetmë të përmbledhur.
 - **SNK 19 Përfitimet e Punonjësve:** Amendimi sqaron se thellësia tregu i obligacioneve me cilësi të lartë të korporatave vlerësohet në bazë të monedhës në të cilën detyrimi është i shprehur, në vend se vendi ku detyrimi ndodhet. Kur nuk ka treg të thellë për obligacione me cilësi të lartë të korporatave në atë monedhë, normat e bonove qeveritare duhet të përdoren.
 - **SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetmë:** Banka nuk ka raportuar asnjë karakteristikë të përgjithshme të pasqyrave financiare të ndërmjetme.
- **SNRF 10, 12 dhe SNK 28: Subjektet e investimit: Aplikimi përjashtim Konsolidimi (i amendamentuar)**

Amendamentet adresuar tri çështje që lindin në praktikë në zbatimin e subjekteve investuese përveç konsolidimit. Banka nuk plotëson përkufizimin e Entit të Investimeve dhe ndryshimet nuk janë të zbatueshme.
- **SNK 1: Iniciativa e shpalesjeve (Amendament)**

Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare më tej inkurajon kompanitë për të aplikuar gjykimin profesional në përcaktimin se çfarë informacioni për të ditur se si t'i strukturojnë ato në pasqyrat financiare. Amendamentet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016. Ndryshimet në SNK 1 janë të fokusuar në sqarimet e kërkesave ekzistuese të konsiderueshme të standardit. Ndryshimet kanë të bëjnë me materialitetin, urdhër nga shënimet, subtotals dhe ndarjes, politikave kontabël dhe paraqitjen e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse (IKO) që rrjedhin nga kontabilizimi në kapitalin neto Investimet. Menaxhimi është duke vlerësuar ndikimin e këtij amendimi si ajo vazhdimisht përpiqet për të përmirësuar prezantimin dhe rëndësinë e informacionit në pasqyrat financiare.

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. PARAJA DHE GJENDJA ME BANKËN QENDRORE

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Paraja e gatshme	11,641	11,760
Paratë në banka – llogaritë rrjedhëse në bankat	11,818	5,021
<i>Shumat e mbajtura në BQK</i>		
Llogaria rrjedhëse	8,741	47,000
Llogaria rezervë statutore	34,082	33,382
Paraja dhe gjendja me Bankën Qëndrore të Kosovës	66,282	97,163

Llogaritë rrjedhëse me bankat korrespondente mbartin në vete interesin që varijon nga 0.1% në 0.15%.

Bilanci dhe rezervat e detyrueshme në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) përfaqëson rezervën e detyrueshme sipas rregulloreve të BQK-së. Rezervat e detyrueshme nuk janë në dispozicion për përdorimet ditore nga banka. Balanca e rezervës së likuiditetit e kufizuar me BQK është e përjashtuar nga paraja dhe ekuivalentët e parasë me qëllim të pasqyrës së rrjedhjes së parasë. Banka Qendrore e Kosovës nuk posedon klasifikimin e kredive të jashtme.

4.1 PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

Paraja dhe ekuivalentet e saj në pasqyrën e qarkullimit të parasë përbëhen:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Paraja dhe gjendja me Bankën Qëndrore të Kosovës	66,282	97,163
Më pak: Rezerva e likuiditetit	(17,041)	(16,691)
Depozitat me maturim më pak se 3 muaj (shënimi 5)	46,010	45,674
Paraja dhe ekuivalentët e saj	95,251	126,146

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR BANKAT

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Depozitat e afatizuar	81,822	60,019
Depozitat në banka të likuiduara	736	742
Rezervimet për zhvlerësime	(736)	(742)
Interesi i përlllogaritur	22	15
Gjithsejt kreditë dhe avancet ndaj bankave tjera	81,844	60,034
Afatshkurtër	81,844	60,034

Depozitat tek Banka në likuidim paraqesin shumën e depozitave tek Banka Kreditore e Prishtinës e cila më 13 mars 2006 ka shkuar në likuidim pas tërheqjes së licencës nga BQK.

Sipas datës 31 dhjetor 2014 të përfshira në gjithsej depozitat e afatizuara janë 8,135 mijë Euro që janë fonde peng për aktivitetet e Afarizmit Financiar (të përfshira në këte shumë janë edhe 64 mijë Euro si të bllokuara) (2013: 7,531 mijë Euro).

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT

Analiza sipas klasave

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Kreditë e klientëve	223,463	205,462
Mbitërheqjet	56,841	59,072
Kreditë kartelat	1,103	934
Garancionet e protestuara	44	58
	281,451	265,526
Provizionet për zhvlerësim të kredive të klientëve	(29,086)	(25,158)
	252,365	240,368
Afatshkurtëra	114,567	113,327
Afatgjata	137,798	127,041

Kreditë dhe paradhëniyet për klientët përfshijnë interesin e shtuar në të ardhurat në shumën prej 1,377 mijë Euro (31 dhjetor 2013: 1,302 mijë Euro). Kreditë dhe paradhëniyet për klientët përfshijnë edhe tarifën e disbursimit të shtyrë nga kreditë për klientët në shumën prej 954 mijë Euro (2013: 1,193 mijë Euro).

Overdaftet paraqiten në strukturën e kredive afatshkurtër të konsumit

Analiza sipas sektorëve është siç vijon:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Kreditë për persona juridik	163,541	163,439
Kreditë për persona fizik	88,824	76,929
	252,365	240,368

Lëvizja e provizionimit për zhvlerësimin e kredive të klientëve është si në vijim:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Provizionet për zhvlerësim të kredive me 1 janar	25,158	21,117
Ngarkimi gjatë vitit	4,238	4,041
Kredite e shlyera	(310)	-
	29,086	25,158

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

Zhvlerësimi i ngarkuar fitimit dhe humbjes është detajuar më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Provizioni i vitit	4,238	4,041
Kreditimi tek të hyrat nga interesi	(49)	-
Kthimet nga shlyerjet e kredive	(80)	(157)
Tjera	-	(13)
	<hr/>	<hr/>
Provizioni i ngarkuar i vitit në fitim ose humbje	4,109	3,871

Analiza e provizionimit sipas sektorëve dhe industrive:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Provizioni i ngarkuar per persona fizik:		
Kredi banesore	240	116
Kredi konsumuese	20	(3)
Kredi tjera individuale	382	137
	<hr/>	<hr/>
	642	250
Provizioni i ngarkuar per subjekte juridike:		
Kredi për subjekte juridike	(266)	376
Kredi për subjekte të mëdha	3,862	3,415
	<hr/>	<hr/>
	3,596	3,791
	<hr/>	<hr/>
Gjithsej	4,238	4,041

Një analizë e industrisë së portfolios bruto të kredive për klientët e korporatave para provizioneve është si në vijim:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Afarizëm dhe tregti	28%	30%
Shërbime dhe prodhim	7%	9%
Ndërtimtari	5%	9%
Tjera	60%	52%
	<hr/>	<hr/>
	100%	100%

Më 31 dhjetor 2014, dhjetë kredimarrësit kryesor përbëjnë 14.5% (2013: 13.7%) të totalit të portfolios kreditore.

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

7. HUMBJET DHE PROVIZIONET TJERA

Provizionet dhe humbjet e tjera janë të përfshira në Detyrimet e tjera në notën 15. Ngarkesa e vitit në pasqyrën e të ardhura është detajizuar më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Rezerva per raste gjygjësore	615	187
Provizioni për vjedhjet dhe keqpërdorimet e fondeve	-	14
Provizioni për zhvlerësimin për asetet e konfiskuara (shlyera)	-	9
Rezerva per garancione	9	1
Gjithsej ngarkesa e vitit	624	211

8. PASURITË FINANCIARE NË DISPOZICION PËR SHITJE

Analiza sipas klasave të pasurive financiare në dispozicion për shitje

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Bono thesari të lëshuara nga Qeveria e Sllovenisë	-	4,041
Bono thesari të lëshuara nga Qeveria e Kosovës	49,058	46,062
Bono thesari të Shtetit të Belgjikës	-	4,001
AFS investimet ne aksione	176	-
Gjithsej pasuritë financiare në dispozicion për shitje	49,234	54,104
Afatshkurtër	49,234	54,104

Bonot e thesarit me zbritje të qeverisë së Kosovës me maturitet prej gjashtë dhe dymbëdhjetë muajsh kanë rendimente më të larta që variojnë nga 0.45% – 2.40 %. Bonot Sllovene kanë maturuar në shkurt dhe bonot e thesarit të Belgjikës kanë maturuar në maj dhe nuk janë ripërtrirë më. Rezervat e rivlerësimit me 31 dhjetor 2014 është 0 mijë Euro (2013: 106 mijë Euro). Të gjitha asetet financiare të gatshme për shitje janë me kthim fiks të interesit.

Më 31 dhjetor 2014 nuk ka borxhe te siguruara me kolateral nga palët e treta.

Asetet financiare në dispozicion për shitje përfshijnë interesin e përlogaritur në shumën prej 0 Euro (2013: 23 mijë Euro) dhe pjesën e mbetur të diskontit në shumën prej 363 mijë Euro (2013: 300 mijë Euro).

Investimet në AFS aksione përfaqëson aksionet në VISA Inc, te Klasës C të aksioneve, të kuotuar në treg aktiv. Këto instrumente të kapitalit janë dhënë nga VISA inc për të gjithë anëtarët e saj pa asnjë konsiderate. Vlera e drejtë e instrumentave në datën e dhënies se tyre eshte njohur nga Banka në të ardhurat e vitit aktual.

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

9. PASURITË TJERA

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Shpenzime të parapaguara	582	400
Kolaterali i konfiskuar në kreditë e pashlyeshme	47	77
Inventari	31	53
Pasuritë e tjera financiare	10	19
Gjithsej pasuritë tjera	670	549
Afatshkurtër	670	549

Kolaterali i konfiskuar në kreditë e pashlyera përbëhet nga patundshmëritë dhe pajisjet

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM
 Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

10. PRONA DHE PAJISJET

Kostoja:	Ndërtesat	Përmirësimet për qiradhënie	Mobilitetë dhe pajisjet	Kompjuteret dhe pajisjet e lidhura	Puna në progres	Veturat motorike	Gjithsej
Më1 janar 2013	3,251	991	3,620	1,527	6,448	588	16,425
Shtesat gjatë vitit	3	82	227	196	832	58	1,398
Transferet	6,985	-	295	-	(7,280)	-	-
Riklasifikimet	(1)	13	8	(20)	-	-	-
Shlyerjet	(3)	(24)	(189)	(73)	-	(175)	(464)
Më 31 dhjetor 2013	10,235	1,062	3,961	1,630	-	471	17,359
Shtesat gjatë vitit	2,030	58	172	197	-	34	2,491
Shlyerjet	(9)	(132)	(310)	(98)	-	(48)	(597)
Më 31 dhjetor 2014	12,256	988	3,823	1,729	-	457	19,253
Zhvierësimi i akumuluar:							
Më1 janar 2013	1,152	565	2,733	1,146	-	548	6,144
Shpenzimi për vitin	165	126	393	139	-	45	868
Riklasifikimet	(9)	21	19	8	-	(39)	-
Shlyerjet	(3)	(20)	(156)	(73)	-	(157)	(409)
Më 31 dhjetor 2014	1,305	692	2,989	1,220	-	397	6,603
Shpenzimi për vitin	317	142	406	157	-	38	1,060
Shlyerjet	(5)	(131)	(298)	(95)	-	(41)	(570)
Më 31 dhjetor 2014	1,617	703	3,097	1,282	-	394	7,093
Vlera e mbetur Neto:							
Më 31 dhjetor 2013	8,930	370	972	410	-	74	10,756
Më 31 dhjetor 2014	10,639	285	726	447	0	63	12,160

NLB PRISHTINA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE
PËR RAPORTIM

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

11. ASETET E PAPERKSHME

	Softveri
Kostoja:	
Më 1 janar 2013	2,002
Shtesat	169
Më 31 dhjetor 2013	2,171
Shtesat	134
Shlyerjet	-
Më 31 dhjetor 2014	2,305
Amortizimi i akumuluar:	
Më 1 janar 2013	1,406
Shpenzimi për vitin	203
Më 31 dhjetor 2013	1,609
Shpenzimi për vitin	214
Më 31 dhjetor 2014	1,823
Vlera e regjistruar Neto:	
Më 31 dhjetor 2013	562
Më 31 dhjetor 2014	482

Të gjitha pasuritë e paprekshme janë pasuri të marra dhe të amortizuara përgjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme.

12. DETYRIMET NDAJ BANKAVE

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Llogaritë rrjedhëse	1,015	866
Gjithsej detyrimet ndaj bankave	1,015	866
Afatshkurtër	1,015	866

Detyrimet ndaj bankave paraqesin depozitat e bankave lokale dhe të huaja që kanë llogari në bankën tonë.

NLB PRISHTINA SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

13. DETYRIMET NDAJ KLIENTËVE

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Depozitat rrjedhëse		
Ndërmarrjet	58,260	63,147
Qytetarët	129,086	84,639
Organizatrat financiare	15,291	10,070
Qeveritë	4,818	80
	207,455	157,936
Depozitat e afatizuara		
Ndërmarrjet	20,854	46,180
Qytetarët	176,341	203,747
Organizatrat financiare	-	-
	197,195	249,927
	404,650	407,863
Gjithsej detyrimet ndaj klientëve (depozitat)		
Afatshkurtër	340,377	334,596
Afatgjatë	64,273	73,267

Në detyrimet ndaj klientëve, përfshihet edhe interesi i përlogaritur në shumën prej 2,993 mijë Euro (2013: 5,213 mijë Euro).

Analiza sipas klasës afariste për depozitat e afatizuara dhe llogaritë rrjedhëse është si vijon:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Spektori	% e gjithsej detyrimeve ndaj klientëve	% e gjithsej detyrimeve ndaj klientëve
Qytetarët	75%	71%
Ndërmarrjet dhe entitetet e tjera ligjore	25%	29%
	100%	100%
	% e gjithsej detyrimeve ndaj klientëve	% e gjithsej detyrimeve ndaj klientëve
Qytetarët	305,427	288,386
Ndërmarrjet dhe entitetet e tjera ligjore	99,223	119,477
	404,650	407,863

NLB PRISHTINA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

14. DETYRIMET TJERA FINANCIARE

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
